



USHTRIA



Viti i 70-të i botimit Nr. 20 (82718)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 maj 2017

DITA E VIZITORËVE TË SHQUAR



Stërvitja "LogEx-17", forcimi i lidhjeve NATO-Partneriteti për Paqe

Në kuadër të Stërvitjes "LogEx-17" u zhvillua të mërkurën më 17 maj 2017, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes Dita e Vizitorëve të Shquar. Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, ambasadorë, gjeneralë dhe drejtore drejtorish në MM dhe SHP.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i J4, kolonel Dritan Stroni, i cili falënderoi dhe vlerësoi punën e bërë për arritjen e kësaj stërvitjeje shumëkombëshe. Ai përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe e vlerësoi punën e tyre si cilësore dhe të efektshme. Edhe drejtori i J4 të EUCOM, admiral Paul... » faqe 5

Kujtim Laro, një jetë kushtuar pentagramit

Përkujtohet 70-vjetori i lindjes së kompozitorit të madh, Artistit të Merituar Kujtim Laro



» faqe 9

Bruksel, 25 maj 2017: Përfundon takimi i krerëve të NATO-s

NATO do të bëhet anëtare e plotë e Koalicionit Global

Stoltenberg: "Vendimet që kemi marrë sot do ta bëjnë Aleancën më të fortë dhe më të sigurt, ndërsa ne vazhdojmë të përshtatemi me sfidat e reja"

» faqe 3



Arkivi Ushtarak i FA

Dokumente gjermane në Shqipëri dhe Ballkan gjatë Luftës së II-të Botërore

Prof. Asoc. DR. BERNARD ZOTAJ

Këto ditë ka dalë nga shtypi Buletini Arkivor Ushtarak, organ teoriko-arkivor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1951, datë 29 shtator 2016. Ky bulletin nr. 1-2/2017 ka një fond të pasur me...



» faqe 8

Forca Tokësore

"Tankodromi-17", kompania në operacionin mbrojtës

Në periudhën 10 - 12.05.2017 për rreth 72 orë, efektivat e k2b3k të Forcës Tokësore, realizuan me sukses stërvitjen "Tankodromi-17 me temë: "Veprimet e kompanisë së këmbësorisë në operacion mbrojtës". Stërvitja në nivel kompanie, pati si rajon të zhvillimit të saj zonën e Poshnje – Pashalli... » faqe 6

BRUKSEL 25 MAJ 2017

NATO mishëron lidhjen unike Evropë-SHBA

» faqe 11

ALEKSANDËR SHKULAKU RENDITET NË VEND TË TRETË

"Komandot" e Forcës Tokësore vend nderi në Kroaci

faqe 6

OPINION

Rishikimi i mbrojtjes në kontekstin e rrezeve aktuale

N/kol (R) Msc KANAN HIMAJ

faqe 4



Tirana, 5-17 shtator 2017

Takimi i Komitetit Ushtarak të NATO-s

Në Shtabin Qendror të NATO, Bruksel, Belgjikë u zhvillua më 17 maj 2017 takimi i radhës i Komitetit Ushtarak në formatin e SHSHP të vendeve të NATO dhe drejtuesit e strukturave komanduese dhe misioneve të NATO, atyre të vendeve të Dialogut të Mesdheut.

Takimi i Komitetit Ushtarak u hap me takimin që sekretari i Përgjithshëm i NATO, Jens Stoltenberg, kishte me SHSHP të vendeve të NATO. Sekretari i Përgjithshëm i NATO, Jens Stoltenberg dhe kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO gjeneral Petr Pavel, vlerësuan kontributin e vendeve të NATO dhe ato partnere gjatë aktivitetëve dhe misionëve për vitin 2017. Ndër të tjera, Komiteti Ushtarak i NATO trajtoi çështjet kyçe të sigurisë së Aleancës në krahun jugor (kryesisht në projektimin e stabilitetit, luftës kundër terrorizmit, çështjet e “Resolute Support Mission” dhe strategjinë, strukturën dhe transformimin e ardhshëm të NATO. Përfaqësuesi më i lartë civil i NATO, ambasador Zim-



mermann dhe komandanti i “Resolute Support Mission”, gjeneral Nicholson, me anë të prezantimeve, i njohu shefat e shtabit, me situatën politike dhe ushtarake nga i cili paraqiti rekomandime për vitin 2018 e më pas. Ndërsa me

interes të veçantë u ndoq prezantimi i mbajtur nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Dedë Prenga për punën e bërë, masat e marra, dhe mundësitë që do të ofrojnë pjesëmarrja në Takimin e Komiteti

Ushtarak të NATO që do të zhvillohet në Tiranë nga 15-17 shtator 2017, jo vetëm për përmbushjen e agjendës së këtij takimi, por si një mundësi e njohjes së historisë, kulturës, traditave dhe kulinarisë së Shqipërisë. Gjatë qëndrimit

në Bruksel, zëvendës shefi i SHP të FARSH, gjeneral brigade Dedë Prenga, u takua edhe me ushtarakët shqiptarë që shërbejnë në Përfaqësinë Ushtarake të NATO dhe në Komandën Operacionale të NATO në Mons, Belgjikë.

Shtabi Qendror i NATO-s, Bruksel-Belgjikë

Komiteti Ushtarak i SHSHP i vendeve të Bashkimit European

Në këtë takim mori pjesë edhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Dedë Prenga në statusin e vendit partner



Në Shtabin Qendror të NATO, Bruksel, Belgjikë, u zhvillua më 16 maj 2017, takimi i radhës i Komitetit Ushtarak në formatin e SHSHP të vendeve të Bashkimit European. Në këtë takim mori pjesë edhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Dedë Prenga në statusin e vendit partner. Në sesionin e veçantë me partnerët, morën pjesë shefat e shtabit të vendeve anëtare të BE, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO, komandanti i ACO, komandanti i AFRICOM, dhe

shefat e shtabit të vendeve partnere Afrika Qendrore, Ukrainë, Gjeorgji, Serbi, Shqipëri, Mal i Zi, Moldavi, Bosnje Hercegovinë.

Pjesa e parë e sesionit të veçantë vijoi me “partneritetet”, ku objekt ishte përditësimi i situatës aktuale në Ukrainë (informim nga SHSHP ukrainase), ndërsa pjesa e dytë vijoi me “Objektivat dhe gjendja aktuale e misionëve këshilluese dhe trajnuese të drejtuara nga BE”. Në këtë pjesë shefat e shtabit do të përditësohen mbi “Objektivat dhe gjendja aktuale e misionëve këshilluese dhe trajnuese

të drejtuara nga BE” (prezantim nga Komiteti Koordinues Ushtarak i Partneriteteve, shefi i Shtabit të Afrikës Qendrore dhe komandanti i Komandës së Afrikës).

Misionet këshilluese dhe trajnuese të drejtuara nga BE, janë në Republikën e Afrikës Qendrore (EUTM RCA), Somali (EUTM Somalia) dhe Mali (EUTM Mali). Në këtë mision trajnues merr pjesë edhe vendi ynë me një ekip trajnuesish të EOD prej 4 ushtarakësh (2 oficerë dhe 2 nën-oficerë). Aktualisht ndodhet në mision ekipi i tretë.

Komanda Mbështetëse në ndihmë të komunitetit

Batalioni i Xhenios i Komandës Mbështetëse me mjetet e saj të rënda ka vijuar punën për hapjen e një segmenti rrugor sa të vështirë aq edhe të rëndësishëm për banorët e fshatit Osnat të Njësisë Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec. Prej vitesh është kërkuar nga banorët e kësaj zone të thellë që të bëhet i mundur ndërtimi i këtij segmenti rrugor i cili mundëson komunikimin në distancë më të shkurtër me qytetin e Pogradecit, Përrenjasit dhe atë të Gramshit. U desh ndërhyrja e Batalionit të Xhenios që ky segment rrugor në përfundim të punimeve, të bëhet funksional dhe në shërbim të komunitetit. Edhe pse terreni është tepër i vështirë, efektivët e xhenios vazhdojnë punimet për hapjen e kësaj rruge të re. Konkretisht, mjetet e rënda të batalioni i xhenios janë përqendruar në gërmimin e dherave, drenazhimin dhe sistemimin e këtij segmenti. Ky segment rrugor tepër i rëndësishëm ka një gjatësi prej 8800m, i cili do tu vijë në ndihmë banorëve të zonave të thella malore si Osnat, Niç dhe Strekanj të Njësisë Administrative Dardhas.

Ndërkohë, specialistët e Batalionit të Xhenios (bXH) u përqendruar para disa ditësh në fshatin Pishkash, Njësi Administrative Qukës të Bashkisë Përrenjas për asgjësimin e një masivi shkëmbor në zonën e quajtur “Sofra e Skënderbeut”, i cili si pasojë e gërryerjes nga reshjet e dendura në këtë zonë ka bërë që ky masiv të rrezikojë shtëpitë e ndërtuara pranë këtij shkëmbi.

Në këtë operacion u angazhuan 13 specialistë si dhe 3 mjete e 1 agregat. Pas një studimi që specialistët xhenierë në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave në Bashkinë Përrenjas i bënë zonës, u morën të gjitha masat dhe u vendos që shkatërrimi i masivit shkëmbor me një vëllim rreth 200 m3 të bëhej me shpërthim të kontrolluar, me qëllim ruajtjen e vlerave historike që mbart ky shkëmb. Edhe pse në kushte jo të favorshme teknike specialistet e Kompanisë së Ndërtimeve të bXH punuan intensivisht dhe finalizuan me sukses këtë operacion dhe eliminuan rrezikun e shembjes së masivit shkëmbor, shumë fare pranë shtëpive të banorëve.



Bruksel, 25 maj 2017: Përfundon takimi i krerëve të NATO-s

NATO do të bëhet anëtare e plotë e Koalicionit Global

Stoltenberg: “Vendimet që kemi marrë sot do ta bëjnë Aleancën më të fortë dhe më të sigurt, ndërsa ne vazhdojmë të përshtatemi me sfidat e reja”

Udhëheqësit e NATO-s përfunduan takimin në selinë e re të NATO-s në Bruksel më 25 maj 2017, ku nga Shqipëria morën pjesë Kryeministri z.Edi Rama, Ministri i Punëve të Jashtme Ditmir Bushati dhe Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli. Takimi i Brukselit ishte një demonstrim i fuqishëm i unitetit dhe vendosjes transatlantike, me aleatët që morën vendime të rëndësishme për të bërë më shumë në luftën kundër terrorizmit dhe për të siguruar ndarje më të drejtë të barrës në NATO. Aleanca ra dakord me një plan veprimi për të bërë më shumë në luftën kundër terrorizmit. “NATO do të bëhet anëtare e plotë e Koalicionit Global, në të cilin të gjithë 28 aleatët tashmë marrin pjesë”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Ai vuri në dukje se kjo do t'i mundësojë NATO-s të marrë pjesë në diskutimet politike, duke përfshirë koordinimin e trajnimit dhe ngritjen e kapaciteteve. Aleanca do të rrisë mbështetjen e saj ndaj Koalicionit, me avionët e mbikëqyrjes të NATO-s AWACS që ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të hapësirës ajrore. “Ne gjithashtu vendosëm të krijojmë një qelizë të inteligjencës së terrorizmit brenda Divizionit tonë të Inteligjencës. Kjo do të përmirësojë ndarjen e informacionit midis aleatëve, duke përfshirë kërcënimin e luftëtarëve të huaj”, tha Stoltenberg.

Udhëheqësit e NATO-s gjithashtu ranë dakord të bëjnë më shumë për të siguruar ndarjen më të drejtë të barrëve në të gjithë Aleancën. Presidenti amerikan Donald Trump u ka kujtuar vendeve anëtare të aleancës se duhet të përmbushin detyrimet financiare ndaj aleancës. “E ardhmja e NATO-s duhet të përfshijë një fokus të madh tek terrorizmi dhe imigracioni, si dhe kërcënimet nga Rusia në kufijtë jugorë dhe lindorë të aleancës. Këto shqetësime të thella janë të njëjtat arsye përse kam qënë shumë i drejtëpërdrejtë me sekretarin Stoltenberg dhe anëtarë të aleancës duke thënë se anëtarët e NATO-s duhet të kontribuojnë më në fund në përmbushjen e detyrimeve të tyre financiare”.

“Sot vendosëm të zhvillonim plane vjetore kombëtare, duke përcaktuar se si Aleatët synojnë të përmbushin premtimin për investime në mbrojtje, të cilat i bëmë së bashku në vitin 2014. Planet kombëtare do të mbulojnë tri fusha kryesore: paratë, aftësitë dhe kontributet”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Udhëheqësve të NATO-s iu bashkua Presidenti Vujanoviq i Malit të Zi. Mali i Zi së shpejti do të bëhet anëtar i njëzetënëntë i Aleancës së NATO-s në një shenjë të qartë se dera e anëtarësimit në NATO mbetet e hapur”, tha Stoltenberg.

Mbrojtje e fuqishme, e kombinuar me dialog kuptimplotë

Në konferencën për shtyp që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, mbajti pas takimit të Shefave të Shtetit dhe Qeverive të NATO-s në Bruksel më 25 maj 2017 tha se, “Ne sapo kemi përfunduar një takim shumë të mirë të shefave të shteteve dhe qeverive të NATO-s. Ne morëm vendime të rëndësishme për ndarjen e barrës dhe për të rritur luftën kundër terrorizmit. Belgjika ia dorëzoi NATO-s selinë tonë të re, një shtëpi të shekullit të 21-të për një aleancë të shekullit 21. Kancelarja



Merkel i dedikoi Përkujtimin e Murit të Berlinit, një simbol të lirisë sonë, të cilën NATO ekziston për të mbrojtur dhe Presidenti Trump i kushtoi Memorialin e 11 shtatorit dhe Nenin 5.

Një kujtesë e fuqishme e solidaritetit të NATO-s dhe rëndësia e luftës sonë të përbashkët kundër terrorizmit. Një nga çështjet kryesore që kemi diskutuar ishte lufta kundër terrorizmit. Kjo luftë kërkon një gamë të gjerë instrumentesh: agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit, koalicioni për të mposhtur ISIS-in, Bashkimi Evropian, si dhe aleatët individualisht, po japin kontribute të paçmueshme. Sot ramë dakord për një plan veprimi për NATO-n për të rritur përpjekjet e saj në luftën kundër terrorizmit. Ne shqyrtuam misionin tonë të trajnimit në Afganistan, dhe ne ramë dakord që ne do të vazhdojmë të mbështesim misionin tonë. Unë e mirëpres që disa aleatë u paraqitën sot me kontribute të reja të trupave. Dhe në bazë të rishikimit tonë, ne do të marrim vendime të mëtejshme në javët e ardhshme.

Ne gjithashtu vendosëm të zgjerojmë mbështetjen tonë për Koalicionin Global për të mposhtur ISIS. Planet tona të mbikëqyrjes AWACS do të ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të hapësirës ajrore për Koalicionin. Dhe disa aleatë kanë kryer aftësi të karburantit ajror për ajërin për AWACS. Pra, ne do të ndajmë më shumë informacione, do të kemi më shumë orë fluturimi dhe do të kemi edhe karburantin ajror. Në të njëjtën kohë, ne ramë dakord se NATO do të bëhet anëtare e plotë e Koalicionit Global, në të cilin të gjithë, 28 aleatët tashmë marrin pjesë. Të qenit në koalicion nuk do të thotë se NATO do të angazhohet në luftime. Por ajo dërgon një sinjal të fortë të angazhimit tonë për të luftuar terrorizmin global. Dhe kjo do t'i mundësojë NATO-s të marrë pjesë në diskutimet politike, duke përfshirë

koordinimin e trajnimit dhe ngritjen e kapaciteteve.

Ne do të vazhdojmë trajnimin tonë për forcat irakiane. Trupat e Irakut të trajnuar nga NATO për të shpërndarë pajisjet shpërthyes të improvizuara janë tani, duke vënë aftësitë e tyre për t'u përdorur në betejën për Mosul. Ne gjithashtu vendosëm të krijojmë një qelizë të inteligjencës së terrorizmit në kuadër të Divizionit tonë të Inteligjencës. Kjo do të përmirësojë ndarjen e informacionit midis aleatëve. Duke përfshirë kërcënimin e luftëtarëve të huaj. Po punohet gjithashtu për të krijuar një qendër për Jugun në Komandën tonë të Përbashkët të Forcave në Napoli. Ajo vazhdimisht do të monitorojë dhe vlerësojë kërcënimet rajonale, përfshirë terrorizmin.

Po përpiqemi gjithashtu të përdorim më shumë selinë qendrore të Operacioneve Speciale të NATO-s, e cila tashmë ofron trajnime të përshtatura kundër terrorizmit për aleatët dhe partnerët. Kjo mund të përfshijë më shumë ekipe të trajnimit mobil që vendosen në vendet në rrezik.

Pra, Aleanca po bën shumë në luftën kundër terrorizmit. Prandaj unë kam vendosur të caktoj një zyrtar të lartë të NATO-s si koordinator, për të siguruar që plani ynë i ri i veprimit të zbatohet shpejt dhe në mënyrë efektive. Për të mbajtur vendet tona të sigurta në një botë më të paparashikueshme, ne duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtjen tonë. Dhe për të siguruar ndarjen më të drejtë të barrës në të gjithë Aleancën. Kjo ishte tema tjetër

kryesore që diskutuam. Ne kemi bërë progres. Me miliarda më shumë investuar në mbrojtje vitin e kaluar, pas një periudhe të gjatë rënieje. Sot vendosëm të zhvillonim plane vjetore kombëtare, duke përcaktuar se si Aleatët synojnë të



përmbushin premtimin për investimin në mbrojtje, të bëra së bashku në vitin 2014. Planet kombëtare do të mbulojnë tri fusha kryesore: paratë, aftësitë dhe kontributet.

Së pari - si kombet synojnë të përmbushin angazhimin e tyre për të shpenzuar 2% të PBB-së në mbrojtje, nga të cilat 20% duhet të investohen në pajisje të mëdha.

Së dyti - si të investojmë fonde shtesë në aftësitë kryesore ushtarake që na nevojiten.

Dhe së treti - se si Aleatët synojnë të kontribuojnë në misionet, operacionet dhe angazhimet e tjera të NATO-s. Unë e mirëpres që shumë aleatë sonte treguan se si synojnë t'i përmbushin këto qëllime. Grupi i parë i raporteve mbi planet kombëtare do të përfundojë deri në dhjetor të këtij viti. Dhe do të shqyrtohen nga ministrat e mbrojtjes në shkurt. Planet kombëtare vjetore do të na ndihmojnë të vazhdojmë momentin, të investojmë gjithnjë e më shumë në mbrojtjen tonë. Kështu që të gjithë aleatët kontribuojnë në pjesën e tyre të drejtë ndaj sigurisë sonë të përbashkët.

Marrëdhënia e NATO-s me Rusinë ishte një tjetër temë diskutimi. Sot ne riafirmuam qasjen tonë të dyfishtë: mbrojtje e fuqishme, e kombinuar me dialog kuptimplotë, dhe po japim të dyja këto. Aleatët qëndrojnë të fortë së bashku për të mos provokuar konfliktin, por për të parandaluar konfliktin dhe për të ruajtur paqen. Në të njëjtën kohë, ne mbetemi të hapur për dialog me Rusinë, për të rritur transparencën dhe për të ulur rreziqet. Ne e mirëpritëm Kryeministrin Markoviq të Malit të

Zi në tryezën tonë sot. Mali i Zi do të bëhet anëtar i njëzetënëntë i familjes sonë brenda pak javësh. Një shenjë e qartë se dera e NATO-s mbetet e hapur për vendet që ndajnë vlerat tona dhe dëshirojnë të kontribuojnë në aleancën më të suksesshme në histori. Së fundi, u pajtuam që do të takohemi përsëri në një samit të NATO-s në 2018. Vendimet që kemi marrë sot do ta bëjnë Aleancën më të fortë dhe më të sigurt, ndërsa ne vazhdojmë të përshtatemi me sfidat e reja”.



N/KOL (R) MSC KANAN HIMAJ
Qendra e Doktrinës & Kërkimit

Rishikimi i mbrojtjes në kontekstin e rreziqeve aktuale

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes do të vijojë të ndodhë gjatë periudhës 2017-2018, kohë e përshtatshme për të nxjerrë në evidencë problematikën tonë të mbrojtjes

Fillimi i procesit të Rishikimit të Mbrojtjes është moment i cili kërkon së pari, përgjigjen e pyetjes çfarë aftësish, kapacitete dhe mundësish kemi për të rritur fuqinë luftarake të mbrojtjes sonë. Sa dhe si duhet të ndërtojmë dhe përmirësojmë sistemin e mbrojtjes në kushtet e reja të mjedisit të sigurisë së brendshme, rajonale dhe globale. Nisur sa më lartë, përfshirja të lidhshme, studuesve, analistëve dhe drejtuesve nga të gjitha institucionet qendrore të shtetit në proceset e rishikimit do të sjellë një format të plotë të shprehjes së gjendjes dhe të synimeve politiko ushtarake të sistemit të mbrojtjes së vendit.

Rishikimi i dokumentit RSM-2013 bëhet në afatet kohore të përcaktuara 4-5-vjeçare. Vlerësimi dhe analiza e mbrojtjes do të jetë në varësi të realizimit të objektivave dhe detyrave për periudhën afatmesme, të reflektuara për perspektivën e transformimit të mbrojtjes së vendit. Besimi është i lartë për një punë të zellshme në një analizë të plotë e cila do të krijojë një bazë të fortë për drejtimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes, për funksionin e sistemit për zbatimin e misionit.

Shqipëria, së bashku me vendet e tjera aleate, po përballët me një mjedis kompleks dhe shumë dinamik të sigurisë. Operacionet hibride kërkojnë rinovimin dhe masa të tjera shtesë përforcuese ushtarake dhe jo ushtarake për të gjitha hallkat e drejtimit që të bëjnë të mundur rritjen e elasticitetit të aftësive mbrojtjes të vendit dhe në kuadër të mbrojtjes dhe sigurisë kolektive. Në përgjigje të kërcënimeve të reja, NATO dhe aleatët e saj kanë zgjedhur strategjinë e bazuar në pengimin e një agresioni të mundshëm. Këtij koncepti, sigurisht do ti shtohen masa të tjera edhe në Samitin e Brukselit 2017. Kjo strategji do të kufizojë kërcënimet do të mbrojë vendet, dhe qëndrueshmërinë e tyre duke rritur reagimin e dhe gatishmëria për të krijuar mbrojtjen e suksesshme të vendeve. Strategjia po fokusohet në forcimin e mekanizmave të mbështetjes reciproke për ofrimin e sigurisë dhe stabilitetit.

Institucionet e sigurisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm e njeh gjendjen e ndryshuar të sigurisë e cila kërkon aftësitë e duhura mbrojtëse për të adresuar burime të ardhshme të kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Planifikimin i mbrojtjes nevojitet të përmirësohet si një proces i rëndësishëm për të adresuar problemet e ndjeshme në kushtet e sotme, kufizimet e burimeve (përparësitë dhe rreziqet e menaxhimit) dhe kohën e arritjes së aftësive afatgjata (afati kohor i planifikimit afatgjatë). Ai duhet të përmbajë detyrat për kohë paqeje dhe gatishmërinë e FA-ve, ndërtimin e strukturës për kohë krize dhe lufte, krijimin e aftësive për sistemin e mbrojtjes, si dhe masat për luftën hibride.

Nisur nga këndvështrimi ynë për formulimin e dokumentit RSM-2017, qëllim i të cilit është të vlerësojë ndryshimet në politikën e mbrojtjes në lidhje me spektrin e gjerë të sfidave të sig-



urisë në fushat e mëposhtme: politike, ushtarake, administrative, ekonomike dhe shoqërore, ofrojmë disa koncepte të reja.

Tashmë, qëndrimi i politikës për mbrojtjen është në zhvillim, për shkak të ndryshimeve dhe angazhimeve tona ndaj aleatëve. Para së gjithash, shpresojmë se buxheti i mbrojtjes do të kthehet në drejtimin e duhur, në pikën referuese të 2% të buxhetit të NATO-s.

Aftësia për të investuar në mbrojtje nuk dëshmon vetëm gatishmërinë e Shqipërisë për të përmbushur detyrimet e veta ndërkombëtare, por ajo tregon aftësinë e shtetit për të marrë përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen, në përputhje me nivelin e kërcënimit. Në bazë të ligjit "Mbi Kornizën Buxhetore Afatmesme për 2017, 2018 dhe 2019, rritja e shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes në rishikimin e përgjithshëm të objektivave të politikës së mbrojtjes, vlerësohet detyra për të ruajtur një strukturë të balancuar të shpenzimeve të mbrojtjes, duke ndarë më pak se 50% të shpenzimeve për personelin dhe administratën, 30% për mirëmbajtjen dhe 20%, për prokurimin e pajisjeve të reja. Duke u mbështetur

në angazhimet politike ndaj aleatëve për shpenzimet e mbrojtjes, buxheti i mbrojtjes do të rritet gradualisht në rreth 2% të PBB-së për periudhën afatgjatë deri në 2024. Termi i projektimit afatmesëm të shpenzimeve të mbrojtjes duhet të përmirësohet në favor të përparësive dhe aftësive të mbrojtjes, në raport me ndryshimet që kanë ndodhur në mbështetjen e FA-ve. Rritja nominale e buxhetit të mbrojtjes duhet të jetë në atë masë që duhet për të ruajtur aftësitë e arritjeve dhe për të krijuar aftësitë parësore, për të cilat vendi ka nevojë.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes ka përgjegjësinë e përcaktimit të objektivave të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes dhe kapacitetin e saj të nevojshme për vendin, përgjigjen ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë, krijimi e aftësive të gatishmërisë dhe qëndrueshmërinë e Forcave të Armatosura, ndjekjen e objektivit dhe angazhimeve të përbashkëta në kuadër të NATO-s dhe BE-së.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes do të vijojë të ndodhë gjatë periudhës 2017-2018, kohë e përshtatshme për të nxjerrë në evidencë problematikën tonë të mbrojtjes. Kjo përdhë do të

kërkojnë më shumë dakordësi politike dhe sociale me rëndësi për çështjet më të rëndësishme të vendim marrjes politike dhe ushtarake. Siguria e vendit dhe qytetarëve të saj nuk është qëllim në vetvete, por ajo duhet të merret me seriozitetin e duhur në kushtet e një mori kërcënime dhe rreziqe me natyrë hibride. Ne jemi të vetëdijshëm për përpjekjet që duhet të bëjmë për të përmirësuar apo reformuar bazat ligjore, strategjike dhe udhëzime për planifikim e dokumenteve themelor, kërkojnë pjekurinë dhe vetëmohimit në formësimin e konsensusit politik dhe shoqëror.

Kapaciteti i Mbrojtjes së një vendi nuk është një përgjegjësi e ndarë. Fuqia e Aleancës është bazuar në fuqinë individuale të anëtarëve të saj. Çdo shtet anëtar është e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së vendit dhe rezistencë për të parandaluar dhe zbrapsur çdo kërcënim. Aleatët tanë do të sigurojnë mbështetjen për disa aftësi të mbrojtëse.

Ndërgjegjësimi për domosdoshmërinë e ndryshimit e qasjes sonë në trajtimin e çështjeve të sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes mbetet me rëndësi të veçantë për qarqet akademike dhe publikut. Ministria e Mbrojtjes do të vazhdojë të luftojë për diskutime të gjëra politike dhe me ekspertë të interesit, alternativa të objektivave dhe ambicieve në fushën e mbrojtjes, në veçanti për zhvillimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura.

Fillimi i procesit i Ministres së Mbrojtjes do të bëjë të mundur nxitjen dhe zhvillimin për zgjidhje me qëllim të sigurojë efektivitet dhe cilësi të sistemit të mbrojtjes në nivelin e nevojshëm për vendin.

Republika e Shqipërisë është duke u përballur me situatën jo të mirë të mjedisit të sigurisë në rajon dhe 'mjedisin më të gjerë ndërkombëtar. Vendet anëtare të NATO-s kanë qenë tashmë

objekt i veprimtarive terroriste, sulmet kibernetike dhe disa lloje të operacioneve hibride. Ato do të vazhdojnë të përballët me shkallë të gjerë të migrimin të cila përbëjnë një rrezik më të madh të sigurisë. Kërcënimet bashkëkohore, krizat dhe konfliktet e armatosura në rajonin tonë dhe në vendet perëndimore përbëjnë kërcënime potenciale të sigurisë në Republikën e Shqipërisë.

Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është në zhvillim. Momentalisht kërkohet më shumë zhvillim për të arritur nivelin e kërkuar të aftësisë për t'u marrë me kërcënimet e dhe rreziqeve ardhshme për sigurinë kombëtare dhe nuk mund të arrihen gjitha detyrat e caktuara sidomos kapacitetet e nevojshme mbrojtjes. Duke mbajtur parasysh mjedisin e ndërkombëtar të ndryshuar dukshëm është e nevojshme për të marrë masa konkrete për tejkalimin e situatës aktuale.

Forcat e Armatosura shqiptare kanë nevojën për të arritur nivelin e gatishmërisë dhe aftësitë për të vepruar në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake. Modernizimi i Forcave të Armatosura kërkon të bëhet vlerësimi i burimeve njerëzore dhe financiare, trend që duhet të marrë progresin e duhur në të ardhmen.

Republika e Shqipërisë është në një pikë të re politiko-ushtarake dhe është e nevojshme të shqyrtojë rolin e saj aktivë në Aleancë për sigurisë dhe mbrojtjen e vendit. Gjithashtu, ajo rrjedhimisht do të reformojë parimet themelore që përcaktojnë objektivin dhe interesa në fushën e mbajtjes dhe përpjekjet për rritjen e burimeve të mbrojtjes për arritjen e qëllimeve prioritare. Në këtë kuadër do të jetë thelbësore rinovimi strategjisë dhe doktrinës për zbatimin e detyrave që rrjedhin prej rishikimit, si dhe ristartimi i procesi në forcat e armatosura.

Udhëzimet e rishikimit strategjik duhet të përfshijnë vendimin për të ardhmen forcave të armatosura dhe të sigurojë rrjedhimisht statusin, mbështetjen financiare, materiale, personelin, doktrinën dhe kushtet e tjera për forcat e armatosura.

Gjithashtu, projekti duhet të ofrojë mendime që i përkasin reflektimit të së tashmes dhe së ardhmes. Theksojmë se një vend i vogël, me një ushtri të vogël në numër, ka ambicien dhe përgjegjësinë e zbatimit të misionit kushtetues, si dhe përmbushjen e angazhimeve ndaj aleancës së NATO-s, në kuadër të BE-së (si vend aspirant) dhe OKB-së. Udhëzimet e rishikimit strategjik duhet të përfshijnë vendimin për të ardhmen forcave të armatosura dhe të sigurojë rrjedhimisht statusin, mbështetjen financiare, materiale, personelin, doktrinën dhe kushtet e tjera për forcat e armatosura. Pra, analiza dhe reflektimi do të ofrojë mënyrat më efektive për rolin, misionin, aftësitë, planifikimin e burimeve të mbrojtjes, kuadrin ligjor, përpjekjet për transformimin e FA-ve, të drejtura dhe të kontrolluara nga autoritetet civile demokratike të vendit.



Komandanti i KDS, gjeneral brigade Enver Cikaqi vizitë në FA të RSH

Komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) gjeneral së brigade Enver Cikaqi bashku me një delegacion nga FSK-ja, me ftesë të komandantit të KDS-së të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjeneral brigade Manushaqe Shehu, qëndroi për vizitë tri ditore në Republikën e Shqipërisë, me qëllim rast mori pjesë edhe në ceremoninë e përfundimit të Kursit të Lartë të Oficerit.

Delegacioni i FSK-së, është pritur nga zëvendës ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Petro Koçi, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Tonin Marku, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani dhe komandanti i KDS-FARSH, gjeneral brigade Manushaqe Shehu.

Gjatë takimeve, delegacioni i FSK-së, është njoftuar me operacionet dhe stërvitjet që FARSH janë duke zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, si dhe me procesin e modernizimit me armatime dhe pajisje tjera brenda forcës. Gjithashtu u bisedua



edhe për bashkëpunimin e deritanishëm të dy institucioneve, si dhe për thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Bazuar në përvojën që ka krijuar ushtria shqiptare, por edhe

inkuadrimi i saj në strukturat euro-atlantike, është diskutuar gjatë për mënyrat e bartjes së dokumenteve doktrinarë dhe adaptimit të tyre në forcën tonë.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë mbështetur bibliotekën e KDS-FSK-së me dokumente doktrinarë dhe tituj librash të ndryshëm, dokumente dhe libra të cilat do të shërbejnë si bazë e mirë për përpilimin apo rishikimin e dokumenteve aktuale. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe delegacioni i FSK-së, gjatë qëndrimit në Shqipëri vizituan edhe oficerët e lartë të FSK-së, të cilët janë duke ndjekur trajnime në shkollat ushtarake të FARSH. Vizita të ndërsjella ka pas edhe në të kaluarën nga komandantët e të dy Komandave si dhe do të ketë edhe në ardhmen me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve, si dhe të njohjes dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy institucioneve (FSK dhe FARSH) u tha gjatë takimeve.

Dita e Vizitorëve të Shquar

Stërvitja "LogEx-17", forcimi i lidhjeve NATO-Partneriteti për Paqe

Në stërvitjen "LogEx-17" morën pjesë 135 trupa nga Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Kroacia, Finlanda, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Suedia vëzhgues nga Polonia dhe Sllovenia si dhe instruktorë nga SHBA, Britania e Madhe, Austria dhe Franca

Në kuadër të Stërvitjes "LogEx-17" u zhvillua të mërkurën më 17 maj 2017, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes Dita e Vizitorëve të Shquar. Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, ambasadorë, gjeneralë dhe drejtorë drejtorish në MM dhe SHP.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i J4, kolonel Dritan Stroni, i cili falënderoi dhe vlerësoi punën e bërë për arritjen e kësaj stërvitjeje shumëkombëshe. Ai përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit dhe e vlerësoi punën e tyre si cilësore dhe të efektshme. Edhe drejtori i J4 të EUCOM, admiral Paul Verrastro shprehu vlerësimet e tij duke u ndalur tek përmirësimet e ndjeshme të aftësive që kjo stërvitje do të sillte tek të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Gjatë fjalës së tij zëvendësministri i Mbrojtjes shprehu vlerësimin që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ka ndjerë me rastin e organizimit dhe zhvillimit të kësaj stërvitjeje, e cila ishte kontribut për paqen, sigurinë dhe prosperitetin në rajon dhe më gjerë.

Më tej zëvendësministri Koçi shtoi: "Stërvitja ka shërbyer si një tjetër hap pozitiv për rritjen e bashkëpunimit, vijimin e dialogut dhe rritjen e mirëbesimit midis vendeve të rajonit tonë, si dhe forcimin e lidhjeve midis NATO dhe Partneritetit për Paqe."

Zëvendësministri gjatë fjalës së tij rëndësi të veçantë i dha aleatëve, të cilët mbështetën këtë stërvitje dhe bënë të mundur mbarëvajtjen e saj dhe suksesin e deritanishëm, duke e përfunduar fjalën e tij me falënderime për pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për rezultatet që kjo stërvitje ka sjellë.

Stërvitja "LogEx 17", bazohej në doktrinën e NATO duke aplikuar mbështetjen logjistike të përbashkët, për mbështetjen e trupave në operacionet shumëkombëshe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit global të sigurisë. Kjo stërvitje ka zgjatur deri më 19 maj dhe në të morën pjesë 135 trupa nga Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Kroacia, Finlanda, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Suedia vëzhgues nga Polonia dhe Sllovenia si dhe instruktorë nga SHBA, Britania e Madhe, Austria dhe Franca.



Stërvitja "LogEx 17", bazohej në doktrinën e NATO duke aplikuar mbështetjen logjistike të përbashkët, për mbështetjen e trupave në operacionet shumëkombëshe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit global të sigurisë. Kjo stërvitje ka zgjatur deri më 19 maj dhe në të morën pjesë 135 trupa nga Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Kroacia, Finlanda, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Suedia vëzhgues nga Polonia dhe Sllovenia si dhe instruktorë nga SHBA, Britania e Madhe, Austria dhe Franca.

Qendra Stërvitore Pashaliman

Përfundon kursi i trajnimit të nënoficerëve

Në Bazën Detare Pashaliman Vlorë, u zhvillua ceremonia dhënies së certifikatave të kursantëve të cilët përfunduan Kursin Bazë të Nënoficerit dhe Kursin e Avancuar të Nënoficerit të kryer në Qendrën Stërvitore. Në ceremoni morën pjesë zëvendës komandanti i Forcës Detare kapiten i rangut parë Subi Zenelaj, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman kapiten i rangut parë Ferdinand Kreshpani si dhe personeli instruktor i Qendrës Stërvitore të Bazës Detare. Kurset në të cilat morën pjesë gjithsej 9 nënoficerë, filluan në fillim të muajit prill të këtij viti dhe përmblanin program teorik dhe praktik. Në mbyllje të kursit u zhvilluan testimet përkatëse, teorike dhe praktike për secilën lëndë të zhvilluar.



FORCA TOKËSORE

Major Ervin HODO

Në periudhën 10 - 12.05.2017 për rreth 72 orë, efektivat e k2b3k të Forcës Tokësore, realizuan me sukses stërvitjen “Tankodromi-17 me temë: “Veprimet e kompanisë së këmbësorisë në operacion mbrojtës”. Stërvitja në nivel kompanie, pati si rajon të zhvillimit të saj zonën e Poshnje – Pashalli, të Bashkisë Urë Vajgurore.

Qëllimi i stërvitjes ishte planifikimi dhe ekzekutimi i një stërvitjeje kompaktësuese në terren, e thjeshtë dhe efektiv në nivelin taktik, ku synohej të arrihej kompaktësimi i veprimeve të nënrepartëve dhe të adresoheshin në të njëjtën kohë nevojat për trajnimin dhe zhvillimin e dy audiencave stërvitore të rëndësishme: së pari të sigurohej trajnim taktik dhe zhvillim cilësor për personelin e nënrepartëve të manovrës; së dyti të adresoheshin nevojat e trajnimit të nënrepartëve të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit.

Objektivat kryesore të “Tankodromi-17”, ishin përsosja e aftësive për përmbushjen e detyrës në përbërje të grupit, skuadrës dhe togës, duke u dhënë përparësi gjatë kësaj stërvitjeje kompaktësimit të veprimeve kolektive të togës dhe kompanisë dhe bashkëveprimit të armëve organikë nëpërmjet kombinimit të tyre me veprimet taktike; rritja e nivelit të stërvitjes në nënrepartet e b3k në përputhje me misionin dhe Lëstën e Detyrave Themelore (LDTH). Për planizimin dhe realizimin sa më efektiv të kësaj stërvitjeje, pati një angazhim maksimal dhe gjithëpërfshirës si nga shtabi i batalionit, ashtu edhe nga kuadrot dhe efektivi i k2k-së.

Fillimisht, shtabi i batalionit dhe komandanti i k2k zhvilluan rikonicion në rajonin ku do të zhvillohej stërvitja, gjatë të cilit u përcaktua rajoni ku do të ngrihej fushimi i kompanisë, si dhe rajonet e stërvitjes. Planizimi i stërvitjes, filloi duke u mbështetur në Direktivën e Stërvitjes DS 7-1, me nxjerrjen e urdhërit të Komandantit të b3k për përgatitjen e planit- metodik dhe zhvillimin e stërvitjes kompaktësuese me k2k, zhvillimin e takimit të grupit të punës për hartimin e planit metodik, zhvillimin e Konfer-

“Tankodromi-17”, kompania në operacionin mbrojtës



encës Fillestare Planizuese, Konferencës Kryesore Planizuese dhe Konferencës Finale Planizuese, duke u finalizuar me zhvillimin konkret në terren të stërvitjes në datat 10 – 12 Maj 2017.

Stërvitja “Tankodromi-17” u zhvillua në këto tre faza kryesore.

Faza e parë: dhënia e urdhërit operacional

Kjo fazë përfshin dhënien e urdhërit operacional komandantit të kompanisë; planizimi nga ana e komandantit të k2k duke zbatuar procesin e drejtimit të trupave, ngritja e fushimit, organizimi i ruajtjes së fushimit.

Në orën 09.00 të datës 10.05.2017,

në sallën e brifingjeve, me pjesëmarrjen e Komandës dhe shtabit të batalionit, komandantëve të nënrepartëve, si dhe komandantëve dhe zv/komandantëve të togave të k2k-së u bë çelja e stërvitjes duke filluar me një brifing mbi të dhënat dhe skenarin e stërvitjes, të mbajtur nga Shefi i Shtabit të b3k-së, dhe më pas vijoi me dhënien e urdhërit operacional komandantit të k2k-së nga ana e Shefit të Seksionit të Operacioneve dhe Stërvitjes.

Pas marrjes së urdhërit operacional, komandanti i k2k Kapiten Namik Minga, u dha urdhërin paralajmërues komandantëve të togave, duke filluar kështu zbatimin e hapave të Procesit të Drejtimit të Trupave (PDT). Men-

jëherë filloi puna në terren për ngritjen e fushimit të kompanisë me të gjithë elementët e nevojshëm, duke siguruar njëkohësisht marrjen e masave të ruajtjes dhe sigurisë në fushim.

Faza e dytë: zhvillimi i operacionit mbrojtës

Kjo fazë filloi në orën 04.00 të datës 12 Maj 2017 me lëvizjen për në rajonin e detyrës, veprimet në rajonin e përqendrimit, zënia e rajonit të mbrojtjes, përgatitja, veprimet në vijën kryesore të mbrojtjes, veprimet e rezervës për dhënien e kundërsulmit, etj. Për të realizuar skenarin e stërvitjes në kushte sa më të përafërta me realitetin, në stërvitje u angazhuan edhe imitues,

duke ingranuar në këtë proces efektivin e togës së Zbulimit. Në orën 05.00 u dha sinjali i fillimit të mësymjes nga kundërshtari, ku dhe filloi filloi dinamika e zhvillimit të veprimeve luftarakë në rajonin e mbrojtjes. Pjerrësitë lindore të kodrës së Goricës pranë fshatit Pashalli dhe Poshnje, oshëtinë nga breshëritë e armëve të këmbësorisë.

I gjithë aktiviteti stërvitor u ndoq nga Komandanti i batalionit të Tretë të Këmbësorisë nënkolonel Gëzim Marku, dhe u vlerësua nga Grupi i Vlerësimit i ngritur për këtë qëllim, gjatë gjithë fazave të zhvillimit të saj, bazuar në manualin “Sistemi i Vlerësimit Operacional të togës dhe kompanisë së këmbësorisë”.

Faza e tretë: përfundimi i stërvitjes dhe zhvillimi i analizës

Kjo fazë përfshiu përfundimin e stërvitjes, zhvillimin e analizës pas veprimit me personelin pjesëmarrës për evidentimin e arritjes së objektivave të stërvitjes, mbledhja dhe sistemimi i bazës materiale, etj. Stërvitja u zhvillua konform udhëzimeve dhe duke zbatuar me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik gjatë përdorimit të armëve, si dhe u mbajtën parasysh rregullat dhe udhëzimet për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë gjithë zhvillimit të stërvitjes, u vu re një mobilizim maksimal nga i gjithë personeli i k2k për realizimin e detyrave të parashikuara në stërvitje, si dhe një disiplinë shembullore. Në përfundim të stërvitjes, u zhvillua analizë pas veprimit, me të gjithë personelin pjesëmarrës gjatë të cilës u analizuan të gjitha mangësitë dhe problemet që u konstatuan në stërvitje, si dhe u lanë detyra për përmirësimin e stërvitjes në të ardhmen.

“Komandot” e Forcës Tokësore vend nderi në Kroaci

Midis 158 garuesëve nga 48 shtete, Aleksandër Shkulaku renditet në vend të tretë

Nga data 13-20.5.2017 në Knin, Kroaci u zhvillua aktiviteti sportive ushtarak “International Best Soldier Competition”. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, u përfaqësuan në këtë aktivitet me dy ushtarë, efektivë të batalionit “Komando” të Forcës Tokësore dhe përkatësisht me ushtar IV Ylber Tokrri dhe ushtar II Aleksandër Shkulaku.

Ishte pikërisht ky i fundit i cili arriti të ngrinte lart emrin dhe flamurin shqiptar duke u renditur në vendin e III-të midis 158 garuesëve nga 48 shtete të ndryshme, që merrnin pjesë në këto gara. Domethënës dhe shpresëplot, për rezultate edhe më të mira, ishte edhe renditja e



ushtar IV Ylber Tokrri i cili zuri vendin e 12-të.

“International Best Soldier Competition” është një aktivitet sportive ndërkombëtar i përvitshëm, i cili ndër të tjera konsiston në vrapim 32 milje me ngarkesë 22kg, e ndarë në 21 stacione stërvitore. Rezultatet e arritura nga efektivat “Komando” të Forcës Tokësore,

tregojnë edhe një here punën e mirë dhe cilësore që bëhet në këtë repart elitë, jo vetëm nga drejtuesit e tij, por flasin njëkohësisht edhe për disiplinën, përkushtimin, pasionin dhe dëshirën që kanë efektivat ushtarë “Komando”, për të qenë gjithmonë më të mirët e më të mirëve.

BASHKËPUNIMI

Forca Ajrore në Stërvitjen “Menaxhimi i Emergjencave”

Në datën 18 maj 2017, në rajonin e Shkodrës, rruga nacionale Lezhë-Shkodër, u zhvillua Stërvitja “Menaxhimi i Emergjencave”, në kuadër të bashkëpunimit të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ambasada Amerikane. Në këtë stërvitje morën pjesë përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Qendra Operacionale e Emergjencave Civile, Spitali Rajonal Shkodër dhe Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter.

Për realizimin e kësaj stërvitjeje, Forca Ajrore mori pjesë me një helikopter EC 135 si ambulancë ajrore për evakuimin mjekësor nga ajri të të dëmtuarit. Stërvitja u zhvillua në bazë të një skenari, ku një automjet ka pësuar aksident rrugor. Nëpërmjet numrit të emergjencës dhe ambulancës 112 e 127 u bë i mundur koordinimi dhe bashkëpunimi për transportimin e personit të dëmtuar në qendrën spitalore për dhënien e ndihmës mjekësore.



Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore

Në tre kurse certifikohen rreth 53 ushtarakë

Paraditen e dates 19 maj, në ambientet e sallës së konferencave të Komandës së Forcës Tokësore, u organizua ceremonia e përfundimit të kurseve institucionale, për oficerë dhe nënoficerë, në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore. Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, komandanti i Akademisë së Nënoficerëve kolonel Albert Mullaj, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Petrit Çuni, komandanti i Qendrës Stërvitore Gëzim Mustafa, përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore si dhe komandë të reparteve vartës të kësaj njësie.

Fjalën e rastit, e mbajti komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Gëzim Mustafa, i cili pasi bëri një përmbledhje të programit stërvitor, që u aplikua gjatë zhvillimit të kurseve në Qendrën që ai drejton, theksin e vuri tek arritjet e kursantëve. Sipas kolonel Mustafës, ka pasur një rritje të theksuar të nivelit përgatitor të pjesëmarrësve në këtë kurs në krahasim me vitet e tjera, çka tregon vlerësimin që i është bërë përvetësimit të programit, nga ana e kursantëve.

Për të përshëndetur ceremoninë, në emër të kursantëve, fjalën e mori toger Elson Feti, i cili ndoqi Kursin e Avancuar të Oficerit, pranë Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore. Në emër të kolegëve të tij kursantë, toger Feti falënderoi të gjithë stafin drejtues të Qendrës Stërvitore, për mbështetjen që ata iu dhanë gjatë periudhës trajnuese në këtë Qendër. “Ngelet detyrë për ne, që njohuritë që morëm në këto auditorë të mos i mbajmë vetëm për vete, por me anë të punës tonë t’i transmetojmë edhe tek vartësit apo kolegët nëpër repartet



nga vijmë”

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, duke përshëndetur ceremoninë, iu shprehur urimet e tij më të mira të gjithë kursantëve për përmbylljen me sukses të kurseve respektive, duke i falënderuar ata për disiplinën, këmbënguljen dhe

përkushtimin e treguar, në përvetësimin sa më të mirë të programit mësimor. Gjithashtu, gjeneral Cahani, një falënderim të veçantë adresoi edhe për stafin drejtues të Qendrës Stërvitore, si dhe për instruktorët e saj për punën e mirë dhe të palodhur që kanë bërë me kursantët. Me tej ceremonia vazhdoi me

ndarjen e certifikatave dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore, certifikoi nëpërmjet tre kurseve të ndryshme respektivisht: Kursit të Avancuar të Oficerit(KAO), Kursit të Avancuar të Nënoficerit(KAN) dhe Kursit Bazë të Nënoficerit (KBN), rreth 53 ushtarakë.



Nëntetar Josif Agolli, sportisti i mirë ushtarak i Forcës Tokësore

Përfundoi “5 garë-shi” ushtarak në rang Forcash të Armatosura

U organizua më 19 maj 2017, në ambientet e batalionit “Komando” të Forcës Tokësore, ceremonia e përfundimit të “5 garë-shit” ushtarak në rang Forcash të Armatosura.

Në këtë ceremoni, morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, drejtori i J-3/7 në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura kolonel Ilir Xhebexhia, komandati i Akademisë së nënoficerëve kolonel Albert Muallaj, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Petrit Çuni si dhe komandantë të reparteve vartëse të Forcës Tokësore.

Ceremonia u përshëndet nga gjeneral brigade Nazmi Cahani, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këto gara, për nivelin e lartë të disiplinës së treguar, për profesionalizmin dhe shpirtin luftarak gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të këtij aktiviteti. “Pavarësisht se në garë ka gjithmonë vetëm një fitues, në këtë ditë të sotme unë mendoj se të gjithë ju që morët pjesë në këtë eveniment, me rëndësi për sportin ushtarak, pavarësisht renditjes, duhet të ndieni veten fitues, pasi ka fituar shpirti i garës dhe i kolektivitetit tek të gjithë ju dhe ne” - tha ndër të tjera gjeneral Cahani.

Më tej, në fjalën e tij gjeneral Cahani shprehu falënderimet e tij edhe për organizatorët e këtij aktiviteti dhe në veçanti për kapiten Haxhi Shirën, i cili ishte njëkohësisht edhe drejtues i aktivitetit. Ceremonia vazhdoi me ndarjen e certifikatave për ekipet dhe individët fitues, ku ashtu sikurse edhe në garat dhe vitet e tjera, Forca Tokësore arriti sërish të ishte triumfuese.

“5 garë-shi” ushtarak u shtri në një periudhë kohore një javore dhe në përfundim të tij u arritën këto rezultate: vendi i I-rë si ekip-Forca Tokësore; vendi i II-të si ekip-Policia Ushtarake; vendi i III-të si ekip-Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS). Gjithashtu ky aktivitet nxori edhe sportistin më të mirë ushtarak nëntetar Josif Agolli efektiv i Forcës Tokësore.

Përfundon kursi i XI “Komando”

Programi përmbante: vrapimi 27 km me pajime, mbijetesë, alpinizëm në terrene tepër të thepisura shkëmbore, njohuri armatimi dhe qitje me ngarkesë



Falënderim të veçantë adresoi nënkolonel Bala edhe për trupën e instruktorëve të këtij kursi dhe njëkohësisht edhe për Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, për mbështetjen që iu dhanë kursantëve “Komando”, për përvetësimin sa më të mirë të programit stërvitor. Duke iu drejtuar të sapocertifikuarëve “komando”, nënkolonel Bala ndër të tjera tha: “...ju jeni sfidantët

kryesorë të brezave më të vjetër “komando” për të çuar dhe ngritur edhe më lart këtë emër të nderuar dhe për t’i qëndruar gjithmonë besnik motos tonë “jo çdokush dhe gjithmonë mund të jetë “komando”.

Për të përshëndetur ceremoninë, fjalën e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, i cili iu shprehu kursantëve përgëzimet

e tij më të mira për arritjen e përmbylljes me sukses të këtij kursi, kaq të rëndësishëm në jetën e tyre ushtarake. Ai shprehu besimin, se realizimi i këtij kursi nuk do të jetë hapi i tyre i vetëm, por do të jetë një tjetër “tullë” në murin e karrierës së tyre ushtarake. “realizimi me sukses i këtij kursi nga ana juaj, demonstrimet që në patëm mundësi të shikojmë në të gjitha stacionet nga ana juaj, tregojnë më së miri nivelin e profesionalizmit që keni arritur në këto tre muaj, tregojnë shpirtin e çeliktë me të cilin jeni farkëtuar këto tre muaj, tregojnë që ju e meritoni ta mbani me nder dhe krenari beretën e kaltër.” - tha ndër të tjera gjeneral Cahani.

Falënderime të veçanta komandanti i Forcës Tokësore, iu adresoi gjithashtu edhe instruktorëve të këtij kursi, për punën mjaft të mirë të bërë me kursantët për realizimin me sukses të Kursit “Komando XI”. Më pas, Zall-Herri do të gjëmonte sërish nga betimi i trupave “komando”, një betim i cili bën krenar jo vetëm këto trupa, por të gjithë Forcën Tokësore. Ceremonia u mbyll me ndarjen e certifikatave dhe me realizimin e një fotoje të përbashkët.

Uorganizua ditën e hënë, më 22 maj, në mjediset e Batalionit “Komando”, ceremonia e përfundimit të Kursit të XI “Komando”. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, drejtori i J-3/7 në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura kolonel Ilir Xhebexhia, komandati i Akademisë së Nënoficerëve kolonel Albert Muallaj, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Petrit Çuni si dhe komandantë të reparteve vartëse të Forcës Tokësore. Ky aktiviteti, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shikonin veprimet e trupave “komando” në disa stacione si: hedhje nga kulla e alpinizmit, reagimin e skuadrës “komando” në patrullim në kontakt me kundërshtarin, çlirim pengjesh, marrje objekti, qitje precizioni si dhe luftim trup me trup.

Më pas, ceremoninë e certifikimit të kursantëve të Kursit të XI “Komando”, e hapi nënkolonel Besim Bala, komandanti i Batalionit “Komando”, i cili pasi foli për historikun e këtij kursi ndër vite, rëndësinë e tij për forcat “komando” si dhe stërvitjen me të cilën u përballën kursantët, theksin e fjalës së tij, e vuri tek programi stërvitor, të cilit iu nënshtuan këto trupa për rreth 3 muaj. Ky program përmbante tema nga më të larmishmet siç ishin: vrapimi 27 km me pajime, mbijetesë, alpinizëm në terrene tepër të thepisura shkëmbore, njohuri armatimi dhe qitje me ngarkesë. Të gjitha këto tema, ishin hartuar për të nxjerrë më të mirën nga secili kursant.



Prof. Asoc. DR. BERNARD ZOTAJ

Këto ditë ka dalë nga shtypi Buletini Arkivor Ushtarak, organ teoriko-arkivor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1951, datë 29 shtator 2016. Ky bulletin nr. 1-2/2017 ka një fond të pasur me përmbledhje me dokumenta nga Fondi i Komandës Gjermane 1940-1944, të cilat telegrame të ambasadorëve gjermanë në Romë, në Beograd dhe në Konsullatën e Përgjithshme në Tiranë, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme Gjermane për gjendjen në Shqipëri dhe Ballkan, për periudhën nëntor 1940-nëntor 1944.

Këto dokumentet që po ju paraqiten lexuesit ushtarak, por dhe më gjerë, janë përmbledhje nga pjesët e fondit të Komandës Gjermane pranë Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në Tiranë. Ndërsa dokumentet origjinale gjenden në fondin e Arkivit Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Federale Gjermane në Bon. Dokumentet në këtë bulletin botohen sipas origjinalin, pa pasur asnjë ndërhyrje apo interpretim.

Fondi i Komandës Gjermane përfshin dokumente të Komandës Supreme Gjermane, të Komandave Ushtarake Gjermane në Ballkan dhe të përfaqësuesve të ambasadave gjermane në Tiranë, në Romë dhe në Beograd. Ky fond përbëhet prej më se 150 dosje, me një volum rreth 55 mijë fletë. Të gjitha këto dokumentet bëjnë fjalë për veprimtarinë ushtarake të Forcave të Armatosura Gjermane në Shqipëri dhe Ballkan, për veprimtarinë e formacioneve të armatosura shqiptare për çlirim, si dhe për veprimtarinë politike të përfaqësuesve gjermanë në Shqipëri e Ballkan. Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve, kryesisht ato që bëjnë fjalë për Shqipërinë dhe shqiptarët, janë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Shqiptarët kundrejt luftës sillen pa interesim


Buletini nis me telegramin e shifruar, nr. 2159, Romë me 27 nëntor 1940, dërguar shtabit të Përgjithshëm të Forcave Tokësore dhe degës së Atashëve, bën fjalë informatat personale nga Shqipëria dhe në bazë të lajmeve nga burimet e besueshme mbi gjendjen e vendit.

Në këtë telegeram theksohet se në vend në përgjithësi ka qetësi. Eksperiencia shumëvjeçare nën pushtimin e huaj dhe të mbretit të vendit, i kanë treguar popullit se, ndryshimi i rendit asnjëherë nuk ka sjellë ndryshimin e metodës së qeverisjes, të cilat në rastet më të shumta konsistojnë në shfrytëzimin e pashembullt. Më tej thuhet se në fund të fundit greku në vetvete është armiku kombëtar, kështu që çdo përkrahje nga ana e tij nuk ka bazë.

Ajo që htekskohet është se nuk ekziston asnjë organizatë shqiptare, e cila do të mund të bëhet bartëse e luftës për liri. Madje repartet e policisë dhe ushtrisë italiane, që qëndrojnë në vend, janë kaq të forta sa çdo kryengritje duket e pamundur. Deri tani nuk njihet asnjë akt sabotazhi sado i vogël qoftë. Shqiptari nuk është ushtar. Ai vërtet është në gjendje që

Arkivi Ushtarak i Forcave të Armatosura

Dokumente gjermane në Shqipëri dhe Ballkan gjatë Luftës së II-të Botërore



me armë në dorë të mbrojtjes pasurisë së tij. Kjo është e gjitha. Me këtë mund të shpjegohet se përse batalionet shqiptare kanë luftuar kaq keq dhe pjesërisht janë arratisur.

Në telegram shpjegohet se është bërë dhe gabimi që ata nuk i kanë angazhuar në Çamërinë e përzier me shqiptarët, por në rajonin e Korçës me shumë ortodoks. Ndërsa në asnjë çast Shqipëria e Veriut nuk është bërë e pasigurt nga ana e udhëheqësve të bandave si Murat Kaloshi dhe Abaz Kupi, me prejardhje nga Jugosllavia. Shkurtimisht mund të thuhet: Shqiptarët kundrejt luftës sillen pa interesim, megjithëse për humbjen e Italisë gëzohen haptazi. Lindja e trazirave konsiderohet si e pabesueshme, nqs gjendja e italianëve nuk do të keqësohet më shumë. Por, qëndrimi i italianëve është një faktor i cili duhet të merret seriozisht në lidhje me gjendjen shpirtërore në Shqipëri.

Organizim të luftëtarëve shqiptarë për aksione ushtarake

Ndërsa në telegramin nr. 921 më Beograd datë 09.09.1943, i plotfuqishmi i posaçëm për juglindjen, shprehte se i dërguari Zonlajtner, niset nesër me aeroplan për në Tiranë. Aerodromi në Tiranë është në duart tona; komandanti italian është gati për dorëzimin e armëve. Për forcimin e pozitës së tij, sot ka ikur regjimenti i parashutistëve, forca të tjera parashutiste largohen nesër. Jam marrë vesh me gjeneral-feldmarshallin fon Vajks mbi transportin e seksionit i posaçëm Abëer

II për Tiranën i cili, nën udhëheqjen e mirë, do t'i organizojë luftëtarët shqiptarë për liri, për aksionin tonë ushtarak. Pararoja është nisur që sot me aeroplan.

I dërguari gjerman konstatonte se shqiptarët në bisedimin mbi momentin historik të kombit të tyre tregojnë entuziazëm të thellë. Në mënyrë entuziaste është aprovuar deklarata ime se, suksesi i kombit shqiptar do të qëndrojë aq më fortë sa më të mëdha të jenë sakrificat dhe gatishmëria e luftëtarëve shqiptar për tu angazhuar për liri. Në bazë të njoftimit të komandantit suprem për juglindjen se "Forcat e Armatosura Gjermane kanë marrë në duart e tyre pushtetin ekzekutiv në Malin e Zi dhe në Shqipëri". Unë në bisedën e sotme me gjeneral-feldmarshallin fon Vajks dhe shtabin e tij, jam marrë vesh që, duke pasur parasysh madhësinë e aparatit administrativ në Shqipëri dhe në Malin e Zi, për arsye politike, do të veprohet ndryshe. Në Shqipëri duhet të hiqet dorë nga çdo organ ushtarako-administrativ dhe menjëherë të vendoset vetëqeverisja e plotë.

Parulla politike "Shqipëri e pavarur" nuk duhet të dëmtohet me skemën e zakonshme të një aparati ushtarako-administrativ. Duhet të pritët zhvillimi i ngjarjeve në bazë të veprimeve të mia në Tiranë, kurse masat e nevojshme do të zbatohen në marrëveshjet e vazhdueshme personale midis komandantit suprem dhe meje.

Trupat gjermane në Shqipëri 57.000 ushtarë

Në telegramin nr. 88, në Tiranë më 16.10.1943, për Ministrinë e Punëve të Jashtme Gjermane, përfaqësuesin Neubacher, si gjeneral i plotfuqishëm Gjerman në Shqipëri, në emër të qeverisë shqiptare të kërkojë kredinë në masën prej 9.817.600 franga shqiptare për 10-ditëshin e fundit të tetorit, që t'i jepet deri më 19 tetor. Ai shton se gjendja numerike e trupave gjermane në Shqipëri është 57.000 veta. Kredia shpjegohet kështu: shpenzime personale e rroga të ushtarëve, shtesë për frontin, shpenzimet e udhëtimit, shpenzime të mbajtjes, shpenzime material, sigurimi i mjeteve për furnizimin dhe ushqimin, mëditjet e punëtorëve, shtesë për banimin, riparime dhe qiraja e mjeteve të transportit, shpenzime të tjera, si sigurimi i ushqimit për të sëmurët, për mjete, punimet në li-man, material për aviacionin etj. Më tej kredia vazhdon me shpenzime të menjëhershme, rregullimi i stacionit anti-malarik në Tiranë, humbje për binarin Birra-Korça, ndërtimi i aerodromit, për ndërtimet e rrugëve në lidhje me Ministrinë e Punëve Botërore Shqiptare. Në përfundim theksohej se blerja e materialit të fumizimit dhe ushqimeve në Shqipëri për divizionin gjuajtës 118 në Malin e Zi, si dhe për rrogat e ushtarëve për divizionin e përmendur.

Deklarata me rëndësi parimore

Në telegramin e datës 29.01.1944, i plotfuqishmi i posaçëm për juglindjen, Shqipëri, theksohet se me rastin e bisedimit tim me kryetarin e Këshillit të Mëkëmbësisë, Mehdi bej Frashëri, ai më ka dhënë deklarata me rëndësi parimore si vijon: Shqipëria është në gjendjen e "neutralitetit relativ" dhe të 18.000 ushtarë të Forcave të Armatosura Gjermane, të cilët gjenden në vend, i konsideron si miq të saj. Qeveria shqiptare do të bëjë çmos të garantojë sigurimin e Forcave të Armatosura Gjermane, duke angazhuar forcat nacionale, kjo vlen sidomos në rast të invadimit të kundërshtarëve të luftës së Gjermanisë, kundër çdo tentative që popullsia shqiptare të ndërsehet kundër Forcave të Armatosura Gjermane duke provokuar trazira.

Qeveria shqiptare i konsideron agentët e kundërshtarëve të luftës së Gjermanisë, si elemente subversive, të cilët kërcënojnë paqen dhe sigurimin e shtetit shqiptar. Prandaj, ajo do të ndjekë këta agentë provokator dhe do të bëjë të pamundurën, siç ka ndodhur dhe në rastin e gjeneralit anglez Dejvis dhe shtabit të tij.

Mehdi bej Frashëri, i cili si burrë shteti i vjetër i mbretërisë otomane, është shprehur me shumë kujdes për çështjen e neutralitetit, më ka dhënë dy herë të kuptoj se shqiptarët e rinj (nga Kosova), të cilët i janë veçanërisht mirënjohës dhe besnik Reichut, mbajnë një qëndrim pozitiv

kundrejt Gjermanisë dhe se ai aprovon bashkëpunimin e Gjermanisë me atë pjesë të Shqipërisë kundër armiqve të jashtëm.

Këto katër deklarata parimore precizojnë pikëpamjen e një shqiptari kompetent dhe pa dyshim të nderuar për çështjen e "neutralitetit relativ" miqësor të Shqipërisë së pavarur. Gjatë këtyre bisedimeve, unë personalisht kam shprehur se Gjermania mbetet në politikën e saj kundrejt Shqipërisë së pavarur, të cilën e konsideron si një shtet mik. Forcat e Armatosura Gjermane qëndrojnë në vend nga nevojat e luftës, por si miq, dhe llogarisin në sigurimin të cilin e gjen miku në shtëpinë shqiptare sipas traditave të këtij populli. Domethënë... fakti i vazhdimit të luftës në tokën shqiptare për këtë shtet të pavarur mik, konçensionet ekonomike në kuptimin e fumizimit të trupave gjermane në shumën... dhe mjeteve të financimit. Pastaj nga situata e luftës del nevoja politike për Shqipërinë, që në postet me përgjegjësi si të mbaj vetëm ata persona besnikëria e të cilëve karshi Forcave të Armatosura gjermane është garantuar nga çdo anë.

Konstatohet në mënyrë krejtësisht parimore se sovraniteti të cilin ne e respektojmë besnikërisht... duke marrë parasysh... sigurimin e Forcave të Armatosura Gjermane... Nga nevoja e luftës del qartë se pavarësia e Qeverisë Shqiptare nuk duhet në asnjë mënyrë të arrijë deri atje që në vendet me përgjegjësi të sjellin ose të vihen në dispozicion çdo mjet të pushtetit, personave, të cilët në një moment kritik mund të vihen kundër Forcave të Armatosura Gjermane.

Këtë deklaratë parimore e kam dhënë veçanërisht, sepse është vënë re një vërshim i elementëve të pasigurt prozogistë dhe sidomos në korin e vjetër të oficerëve, i cili në pjesën më të madhe është shumë i dyshimtë. Unë kam pas qëllim të kundërt me kuptimin e "neutralitetit relativ" dhe konstatohet se më kuptuam shumë mirë.

Materiale të tjera në bulletin

Buletini është i pajisur dhe me harta operacionale të përdorura nga Forcat e Armatosura Gjermane në Shqipëri, gjatë pushtimit. Vëmendje në bulletin ju është kushtuar dhe ekstrakte të gazetës "Lirija e Shqipërisë", botura prej Fuqive të Armatosura Gjermane në Shqipëri në periudhën 19 qershor-16 tetor 1944. Me interes janë dhe mjaft certifikata dhe vërtetime për diasë ushtarakë gjermanë që kanë dezertuar nga radhët e ushtrisë naziste dhe janë inkuadruar partizanë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Interes paraqitin dhe disa dokumente gjermane për krijimin dhe përbërjen e qeverive në kohën e pushtimit gjerman në Shqipëri. Në fund bulletimi mbyllet me disa të dhëna mbi arritjet kryesore të AQFA në vitet 2014-2016, si dhe foto nga veprimtaria e këtij institucioni.



Kujtim Laro, një jetë kushtuar pentagramit

Përkujtohet 70-vjetori i lindjes së kompozitorit të madh, Artistit të Merituar Kujtim Laro

Në mjediset e Muzeut të Forcave të Armatosura është përkujtuar të premten e javës që kaloi, më 19 maj 2017, me një ceremoni të veçantë, 70-vjetori i lindjes së kompozitorit dhe udhëheqësit artistik të Ansambllit të Forcave të Armatosura, Artistit të Merituar, Kujtim Laro. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koci, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Dedë Prenga, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Tonin Marku, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP, ish-pjesëtarë të Ansambllit të Ushtrisë dhe të Orkestrës Frymore, trupa e Orkestrës Frymore, familjarë të kompozitorit të shquar, ish-kolegë dhe muzikantë, etj.

Në përshëndetjen e tij, zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koci kujtoi jetën e Kujtim Laros që nga vegjëlja e deri në kontributin e tij si kompozitor dhe drejtues në Ansambllin e Ushtrisë. “Vitet 1975-1993 kur punoi në Ansambllin e Ushtrisë e çuan më tej rezultatet e afirmimit profesional gjithnjë në rritje. Kujtimi mbajti lart emrin dhe dinjitetin e institucionit që u rrit më tej bashkë me të. Ky institucion jo vetëm mbajti famën e madhe të kohës së Gaço Avrazit, por ravijëzoi më tej portretin e vet artistik me bashkëveprimin harmonik të strukturave të tij, nën udhëheqësinë profesionale të Kujtimit”, deklaroi z. Koci.

Më tej zëvendësministri i Mbrojtjes foli për karrierën e tij në Trupën Artistike të Forcave të Armatosura dhe vlerësori kontributin e tij. “Kujtimi, si asnjë artist tjetër në Shqipëri për gati 30 vjet (1975-2004), punoi në trupat artistike të Forcave të Armatosura dhe dha një kontribut shumë të rëndësishëm nëpërmjet krijimtarisë dhe personalitetit të tij. Duke e ndjerë veten sa artist dhe kuadër ushtarak deri në gradën nënkolonel ai e pati në qendër të vëmendjes, të kujdesit dhe të krijimtarisë së vet jetën e ushtrisë, dedikim për ushtarakët dhe artistët në Forcat e Armatosura”, - tha z. Koci.

Zëvendësministri i Mbrojtjes nënvizoi faktin se “Ndaj artistit të madh, shteti shqiptar është debitor, për arsye se Kujtim Laro për kontributin e madh që ka dhënë në muzikën shqiptare duhej të ishte nderuar me titullin “Nderi i Kombit”. Fjalë të ndjera për Kujtim Laron thanë dhe miqtë dhe bashkëpunëtorët të cilët ngritën lartë vlerat e tij njerëzore dhe ato profesionale.

QKMBMMFA, në nder të tij kishte përgatitur një dokumentar me muzikën, kolonat zanore të filmave më të arrirë, mes të cilëve “Lulëkuqe mbi mure”, këngët fituese të festivaleve kombëtare, intervista të dhëna më parë nga vetë



kompozitori që s’jeton më dhe intervista të bashkëpunëtorëve të tij, i cili u shfaq dhe krijoi emocione për të pranishmit. Ndërsa Banda Frymore e Forcave të Armatosura luajti muzikën e Kujtim Laros, të shoqëruar dhe nga këngëtarja Paola Kotani.

Kujtim Laro lindi në qytetin e Vlorës, në 1947 dhe gjithë jeta e tij iu kushtua pentagramit. Studimet e larta i përfundoi në vitin 1970 në Institutin e Lartë të Arteve. Në periudhën 1970-1975, ai punon në redaksinë e krijimtarisë muzikore të Radio Televizionit Shqiptar, së bashku me Gjon Simonin, Ferdinand Dedën, Aleksandër Lalon etj. ku jep një kontribut të vlefshëm për inkurajimin edhe të krijuesve të tjerë. Kësaj periudhe i takon një krijimtari e gjerë në shumë gjini e zhanre. Ndër më të rëndësishmet janë: “Baballarët”, “Poemë simfonike nr. 2, muzika e filmave “Yjet e netëve të gjata” (1972), “Në fillim të verës” (1975), shumë këngë, vepra të mëdha vokale etj.

Siç thamë më sipër, pas vitit 1975 e deri në 28 korrik 2004 kur në moshën 57 vjeçare u nga jeta, ai kontriboi u në Ansambllin e Ushtrisë dhe trupat artistike të FA. Nevojave për krijimtari të kësaj trupe, ai diti t’u përgjigjet më së miri e më se cilësisht. Ai u përshtat dhe u integrua plotësisht në profilin e ansambllit, ku vend të rëndësishëm zinte tema e mbrojtjes dhe atdheut. Kështu, në periudhën e ansambllit të UP-së ai krijoi mbi 16 tablo koreografike e ndër të cilat evidentohen: “Labëria”, “Bilbilenj të trembëdhjetë”, “Vëlla e

motër”, “Yje për liri”, “Pesë heronjtë e Vigut” etj.

Periudhës krijuese në ansambllin e UP-së i takojnë me dhjetëra këngë, korale, kantata, përpunime, suita vokale etj. ndër të cilat shquhen: “Baladë për Selam Musanë”, “40 vjet shqiponjë e lirë”, “Baladë për Ismail Qemalin”, “Malet nuk tunden nga era” etj.

Gjithashtu, kësaj periudhe i takojnë tre “Poema simfonike”, katër “Rapsodi”, “Koncerti nr.2 për violinë dhe orkestrë”, një “Uverture”, e shumë krijime vokale e koreografike, si dhe muzikën e shumë filmave artistikë.

Kjo është periudha kur kompozitori Kujtim Laro shpalos energji të pashtershme krijuese. Ai aktivizohet me krijimtarinë e tij në konkurset kombëtare, në dekadat e majit në festivalet e këngës në RTSH, në kinemanë shqiptare etj. duke u bërë një nga krijuesit më aktivë në jetën muzikore shqiptare.

Kujtim Laro mbante titujt “Artist i Merituar” dhe “Naim Frashëri” i klasit të parë.

Kompozitori Kujtim Laro ka lënë pas rreth 35 kolona zanore filmash shqiptarë, dhjetëra këngë festivalesh, si këngët “Buka e duarve tona”, “Derdhën gjak dhe hodhëm rrënjë”, “Në çdo zemër një herë troket”, “Vala dhe shkëmbi”, “Gjurmë të arta”, etj. Në kujtesën e shqiptarëve ai mbahet mend më së tepërmi si kompozitor filmash. Firmën e tij mbajnë kolonat zanore të filmave të njohur, si “I teti në bronz”, “Në fillim të verës”, “Lulëkuqet mbi mure”, “Udha e shkronjave”, “Liri a vdekje”, “Nëntori i dytë”, “Militanti”,

“Vendimi”, “Yjet e netëve të gjata”, “Nusja dhe shtetrrethimi”, “Partizani i vogël Velo”, “Fletë të bardha” etj. Krijimi i tij i fundit ka qenë muzika e filmit “Lule të kuqe, lule të zeza”, që u quajt prej kolegëve të tij, si “kënga e fundit e mjellmës”.

Gjatë karrierës së tij, ka bashkëpunuar me regjisorët më të mirë shqiptarë, si Viktor Gjika, Dhimitër

Anagnosti, Mevlan Shanaj, etj. dhe të gjithë ndihen të nderuar prej këtij bashkëpunimi dhe të ngushëlluar prej faktit që muzika e tij do të mbetet e gjallë në filmat e tyre.

Kujtim Laron, Kolegët e tij e quajtën Enio Morrikone, kompozitorin më të madh të të gjitha kohërave në gjininë e muzikës së filmit, të papërsëritshëm, një gjenialitet i prerë në mes.



NATO-Bashkimi European, përparim hap pas hapi

Sekretari i Përgjithshëm përshëndet bashkëpunimin e ngushtë NATO-BE

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, theksoi përparimin që po bëhet në bashkëpunimin më të ngushtë midis Aleancës dhe Bashkimit Evropian në takimin me ministrat e mbrojtjes të BE-së më 18 maj 2017. Ai theksoi se ky bashkëpunim ka arritur një nivel të ri. Sekretari i Përgjithshëm theksoi mbrojtjen kibernetike si një shembull i përparimit të prekshëm. Gjatë sulmeve të ransomëare të fundit, NATO lëshoi një paralajmërim për të gjithë aleatët, si dhe BE, dhe shkëmbyen informacion me BE. Qendra e sigurisë kibernetike e BE-së CERT-BE gjithashtu ka dhënë qasje në Platformën e NATO-s për Shpërndarjen e Informacionit të Malware. “Tani NATO dhe BE janë në gjendje të ndajnë informacion në kohë reale në sulmet kibernetike”, tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm dhe Përfaqësuesi i Lartë Mogherini do të raportojnë për përparimin e bashkëpunimit NATO-BE në Këshillat e të dy organizatave muajin e ardhshëm. Ky bashkëpunim gjithashtu u theksua në takimin e liderëve të NATO-s në Bruksel më 25 maj.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, dha një deklaratë në fillim të takimit të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian në formatin e Mbrojtjes. Ai tha se do të takohet përsëri me ministrat e mbrojtjes të BE-së, duke ju referuar takimit të 25 majit. “I takova muajin e kaluar në Valletta dhe do të takohem përsëri sot, tani ne jemi duke çuar bashkëpunimin NATO-BE në nivele të reja. Kemi transformuar bashkëpunimin dhe po japim shumë rezultate konkrete.

Dhjetorin e kaluar kemi rënë dakord për 42 masa konkrete dhe tani po zbatojmë këto masa. Përfaqësuesi i Lartë Federica Mogherini dhe unë, do të publikojmë një raport muajin e



ardhshëm mbi progresin që po bëjmë në zbatimin e masave për forcimin e bashkëpunimit NATO-BE. Dhe vetëm sa për të përmendur një shembull, për të thënë se sa i rëndësishëm është ky bashkëpunim, unë do të përmend kibernetikën. Për shkak se kërcënimet kibernetike janë diçka që duhet t'i marrim shumë seriozisht, vetëm vitin e kaluar NATO ka përjetuar mesatarisht 500 incidente kibernetike çdo muaj dhe kjo është një rritje prej 60% në krahasim me vitin e kaluar dhe para pak ditësh NATO ka paralajmëruar të gjithë aleatët pas sulmit të ransomëare

që ne pamë. Ne gjithashtu kemi dhënë kohët e fundit qendrën evropiane për qasjen në sigurinë kibernetike në platformën e NATO-s për shkëmbimin e informacionit malware, kështu që tani NATO dhe Bashkimi Evropian janë në gjendje të ndajnë informacion në kohë reale mbi sulmet kibernetike, si sulmi që pamë fundjavën e kaluar.

Pra, ky është vetëm një shembull se si ne po bëjmë përparim, hap pas hapi, në shumë fusha të ndryshme, për të forcuar bashkëpunimin praktik midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Bashkëpunimi midis NATO-s dhe Bash-

kimit Evropian do të jetë gjithashtu një çështje e rëndësishme që do të nxjerrim në pah kur udhëheqësit e NATO-s të takohen pikërisht në 25 maj në Bruksel. Ky do të jetë një takim i shkurtër por do të jetë një takim i rëndësishëm sepse do të jetë takimi i parë ku presidenti i ri amerikan dhe presidenti i ri francez takohen me të gjithë udhëheqësit e tjerë aleatë këtu në Bruksel. Po pres me kënaqësi takimin, do të trajtojmë sidomos dy tema: lidhjen transatlantike dhe ndarjen e barrës dhe përpjekjet e NATO-s për të rritur kontributin tonë në luftën kundër terrorizmit”.

Këshilla dhe rekomandime të pavarura

Më 18 prill 2017 një grup ekspertësh të lartë (GSE) dhanë një raport mbi mënyrën e përmirësimit të ofrimit të aftësive të përbashkëta të NATO-s. Zëvendës Admiral Matthieu Borsboom, Kryetar i Grupit të Ekspertëve të Lartë, ka paraqitur raportin “Qeverisja dhe dorëzimi i aftësive të financuara nga NATO: Përmirësimi i mbështetjes për komandantët e NATO-s” tek Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg që më 24 prill 17. Grupi i ekspertëve të lartë u emërua nga Sekretari i Përgjithshëm më 20 tetor 2016 për të dhënë këshilla dhe rekomandime të pavarura, në përgjigje të dy raporteve të fundit të auditimit të performancës nga Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n (IBAN), të cilat theksuan nevojën për përmirësimin e rregullimit të qeverisjes. Trembëdhjetë ekspertë të GSE erdhën nga vendet e NATO-s me një mori sfondesh dhe përvoja të fituara në nivel të lartë në botën ushtarake, të mbrojtjes dhe akademike. Raportet e auditimit IBAN dhe raporti i Grupit të Ekspertëve të Lartë janë shumë të vlefshme. Aleanca është e angazhuar të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që aftësitë e duhura të dorëzohen në mënyrë sa më efikase dhe më efikase për komandantët ushtarakë”.

Dy mijë ukrainas kanë vizituar selinë e NATO-s

Qendra e Informacionit dhe Dokumentimit të NATO-s në Ukrainë festoi 20 vjetorin e saj

Qendra për Informim dhe Dokumentim e NATO-s (NIDC) në Ukrainë festoi 20 vjetorin e saj në Kiev. Si një zyrë e parë për informim publik që u hap në një vend partner të NATO-s, Qendra e Informacionit e NATO-s ka shërbyer për njëzet vjet për të rritur ndërgjegjësimin për NATO-n dhe për të promovuar NATO-n në Ukrainë. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rose Gottemoeller, e cila vizitoi Kievin më 6-7 prill, iu drejtua takimit nëpërmjet një video-mesazhi nga Brukseli: “Njëzet vjet më parë, NATO vendosi të ngrrej një zyrë në Kiev. Misioni i saj ishte të hapte krahët e tij për këdo që dëshironte të mësonte më shumë për NATO-n. Sot, misioni mbetet i njëjtë. Vetëm duke mësuar rreth njëri-tjetrit mund t'i largojmë mitet dhe stereotipet dhe të ndërtojmë besimin dhe miqësinë në njëri-tjetrin”.

Më 7 maj 1997, Havier Solana, Sekretari i atëhershëm i NATO-s dhe Hennadiy Udovenko, Ministri ukrainas i Punëve të Jashtme, përruruan Qendrën e Informacionit dhe Dokumentimit të NATO-s në Kiev. Karta Karakteristike e Partneritetit NATO-Ukrainë u nënshkrua dy muaj më vonë duke thelluar bashkëpunimin NATO-Ukrainë dhe krijimin e Komisionit NATO-Ukrainë.

Për njëzet vjet, Qendra e Informacionit dhe Dokumentimit e NATO-s (NIDC), është vendosur në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Kombëtar Taras Shevchenko të Kievit. Gjatë kësaj kohe, Qendra ka organizuar më shumë se dyqind udhëtime studimore dhe vizita për studentët, gazetarët, akademikët, parlamentarët në Shtabin e NATO-s në Bruksel. Në përgjithësi, dy mijë ukrainas kanë vizituar selinë e NATO-s në kuadër të këtyre vizitave. Ka realizuar mbi 600 projekte informacioni dhe media. NIDC ka mbështetur gjithmonë shoqërinë civile të Ukrainës dhe ka kontribuar në hapjen e dialogut



për NATO-n. Ajo mbështeti në mënyrë aktive shumë aktorë joqeveritarë gjatë Revolucionit të Dinjitetit, siç është Qendra për Medime të Krizës të Ukrainës, për të siguruar botën me informacione dhe lajme faktike rreth ngjarjeve në terren. Ajo ofroi ndihmë financiare për grupin e aktivistëve që luftuan propagandën ruse dhe ndihmuan në formimin e mediave të reja të pavarura të Ukrainës.

Qendra gjithashtu po mbështet në mënyrë aktive qeverinë e Ukrainës për të krijuar komunikim efektiv strategjik dhe krizash. “Në njëzet vjet angazhim aktiv në Ukrainë, Qendra për Informim dhe Dokumentim e NATO-s ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në Ukrainë. Tema e NATO-s nuk është më tabu dhe shumë nga mitet dhe stereotipet rreth NATO-s janë larguar përmes dialogut aktiv”, tha Carmen Romero, Zëvendës Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Diplomacinë Publike gjatë fjalës së saj në festimet e 20 vjetorit në Kiev.

ALEATET

Paqja në Afganistan dhe procesi i pajtimit

Aleatët e NATO-s dhe partnerët operacionalë që kontribuan në Misionin Resolute Support të udhëhequr nga NATO u takuan më maj 2017, në Shtabin e NATO-s për të shqyrtuar përpjekjet e vazhdueshme në mbështetje të Forcave Kombëtare të Mbrojtjes dhe të Sigurisë Afgane (ANDSF) dhe stabilitetit afatgjatë në Afganistan. Kurse Presidenti i Afganistanit, Shkëlqesia e Tij Mohammad Ashraf Ghani, Komandanti i Misionit Mbështetës të Përhershëm (Gjenerali John W. Nicholson) dhe Përfaqësuesi i Lartë Civil i NATO-s në Afganistan (Ambasadori Cornelius Zimmermann), morën pjesë nëpërmjet videokonferencës. Të pranishmit vunë në dukje përparimin e vazhdueshëm të bërë nga forcat afgane të sigurisë dhe institucionet, pak më shumë se dy vjet që nga marrja e përgjegjësisë së plotë të sigurisë nga Afganistani. Ata gjithashtu theksuan rëndësinë për të vazhduar mbështetjen për ANDSF përmes trajnimeve, këshillimeve dhe përpjekjeve të asistencës nga Misioni Mbështetës i Përhershëm. Takimi shënoi përfundimin e procesit të rishikimit periodik të Mbështetjes së Përhershme. Ai riafirmoi angazhimin e ndërmarrë në Samitin e NATO-s në Varshavë vitin e kaluar për të mbështetur misionin e udhëhequr nga NATO si një mision i bazuar në kushte dhe për të ruajtur konfigurimin e saj nën shqyrtim. Aleatët dhe partnerët e NATO-s riafirmuan misionin si të bazuar në kushte dhe nëpërmjet një modeli fleksibël rajonal. Ata gjithashtu afirmuan mbështetjen e tyre për procesin e gjenierimit të forcave në vazhdim për të siguruar që misioni të ketë burime të duhura. Ky takim ofroi gjithashtu mundësinë për të marrë përsipër përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë së Bashkimit Kombëtar të Afganistanit për të rritur reformat e brendshme dhe për të ruajtur vulltin në fushat kyçe për stabilitetin e Afganistanit, duke përfshirë qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, bashkëpunimin rajonal dhe procesin e paqes dhe pajtimit i udhëhequr nga afganët dhe pranuar nga Afganistani.



Bruksel 25 maj 2017: Takimi i shefave të shteteve dhe qeverive të NATO-s

NATO mishëron lidhjen unike Evropë-SHBA

Udhëheqësit e NATO-s u mbledhën në Bruksel, më 25 maj 2017, për një takim të rëndësishëm në selinë e re të NATO-s. Takimi kishte dy pika kryesore në agjendë: Rritja e rolit të NATO-s në luftën kundër terrorizmit dhe ndarja më e drejtë e barrës në Aleancë. Ndërkohë që Aleanca po bën përparim në të dyja. Ky takim solli së bashku udhëheqësit aleatë nga të 28 vendet anëtare, të cilët dhanë një mesazh të fortë të unitetit dhe solidaritetit. Por takimi i 25 majit 2017, shënoi gjithashtu edhe dorëzimin e selisë të re nga ana e Belgjikës për NATO-n, nën një ceremoni të ngritjes të flamujve. Ky ishte një moment historik: “një shtëpi e re për një Aleancë moderne”.

Vendi ku ndodhet sot selia e re e NATO-s, gjatë të dy luftërave botërore ka qenë një aeroport ushtarak dhe gjatë ndërtimit të selisë së re të NATO-s, atje janë gjetur katër bomba të pashpërthyerë në tokë, “Pra, nga një vend beteje dikur, do të bëhet një vend për dialog dhe bashkëpunim midis aleatëve”, tha Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Gjithashtu selisë të re iu kushtuan dy përmendore, Memoriali i Murit të Berlinit dhe Memoriali i 11 shtatorit dhe Neni 5.

Kancelarja Merkel i kushtoi Memorialin e Murit të Berlinit selisë së re të NATO-s. Segmenti i murit përfaqëson fitoren e lirisë mbi shtypjen. Liria që aleatët vazhdojnë të ruajnë çdo ditë. Kurse Presidenti Trump i kushtoi Memorialin e 11 shtatorit dhe Neni 5. Ky Memorial përkujton herën e parë që aleatët thirrën klauzolën e mbrojtjes kolektive, “Duke simbolizuar solidaritetin dhe luftën tonë të përbashkët kundër terrorizmit”.

Takimi i 25 majit 2017, tregoi se të gjithë aleatët e NATO-s mbeten të bashkuar në luftën kundër terrorizmit në të gjitha format e tij dhe në mbrojtje të shoqërive tona të hapura. Kundërshtimi i terrorizmit “është një sfidë komplekse dhe kërkon një përgjigje të koordinuar, nga agjencitë e zbatimit të ligjit, shërbimet e inteligjencës, sistemet gjyqësore dhe ndonjëherë edhe nga ushtria. Pra, është e rëndësishme që të përdorim të gjitha mjetet që i kemi në mënyrë të plotë”, tha Stoltenberg. Kjo është arsyeja pse një nga dy temat kryesore që u diskutuan ishte rritja e kontributit të NATO-s në luftën kundër terrorizmit. Për t’u marrë me shkaqet rrënjësore të terrorizmit, “trajnimi i forcave lokale është një nga mjetet më të mira që kemi”.

NATO ka ekspertizën, partneritetet dhe fuqinë qendrore për të bërë një ndryshim të vërtetë.

Sot, gati 13.000 trupa të NATO-s dhe vendet partnere kontribuojnë në Misionin Mbështetës të Përhershëm në Afganistan dhe në trajnimin e forcave afgane për të siguruar vendin e tyre dhe për të mohuar strehën e sigurt për terroristët ndërkombëtarë. Por situata e sigurisë mbetet sfiduese, tha Sekretari i Përgjithshëm. “Kohët e fundit kemi përfunduar rishikimin tonë të rregullt të misionit tonë të stërvitjes. Dhe komandantët tanë ushtarakë kanë kërkuar disa mijëra trupa. Ne jemi aktualisht në procesin e prodhimit të forcës dhe pres që vendimet përfundimtare të merren muajin e ardhshëm”.

Të gjithë Aleatët e NATO-s tashmë kontribuojnë në Aleancën Globale për të Mposhtur ISIS dhe NATO e mbështet Koalicionin me informacionin e mbledhur nga avionë të mbikëqyrjes AWACS. Zgjerimi i mbështetjes AWACS të NATO-s për Koalicionin, do të kontribuojë në menaxhimin e hapësirës ajrore, duke e bërë qiellin më të sigurt dhe nga ana tjetër disa aleatë kanë kryer aftësi të karburantit ajror në ajër për AWACS të NATO-s që mbështesin Koalicionin.

Tema tjetër e rëndësishme për takimin ishte ndarja e barrës. Kjo do të thotë përmbyshjen e premtimit që aleatët kanë bërë në 2014: për të ndaluar shkurtime, gradualisht të rriten dhe të shkojnë drejt

shpenzimit të 2% të PBB-së në mbrojtje brenda një dekade, ndërkohë që NATO po bën përparim. Pas shumë viteve të rënies, shpenzimet totale të mbrojtjes nga aleatët evropianë dhe Kanadaja u rritën me miliarda dollarë vitin e kaluar. Por ndarja e barrës nuk është vetëm për shpenzimet, ajo gjithashtu ka të bëjë me aftësitë dhe kontributet për misionet, operacionet dhe angazhimet e tjera të NATO-s.

Aleatët ranë dakord të zhvillojnë plane kombëtare dhe për të raportuar për to çdo vit. Këto plane do të përcaktojnë se si ata synojnë të përmbyshin të tre

aspektet e premtimit: paratë, aftësitë dhe kontributet. U vendos që aleatët do të ndajnë dhe raportojnë për progresin e tyre çdo vit. Ky do të jetë një mjet i ri, për të siguruar që aleatët të vazhdojnë të përmbyshin angazhimet e mara.

Gjithashtu takimit iu bashkua edhe kryeministri Marković i Malit të Zi. Parlamentet e 28 aleatëve dhe ai i Malit të Zi kanë ratifikuar pranimin e vendit në NATO. Ky është një hap përpara për Malin e Zi, për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe për vizionin e NATO-s për një Evropë të tërë, të lirë dhe në paqe.

NATO formalisht do ta presë Malin e Zi si aleatin 29-të në fillim të qershorit.

Takimi i 25 majit tregoi aftësinë e NATO-s për të ndryshuar ndërsa bota ndryshon, për të mbajtur të gjitha kombet e sigurta, siç Aleanca ka bërë që kur u themelua pothuajse 70 vjet më parë. Ajo që u vendos në takim do të ndërtohet mbi atë që NATO ka arritur në vitet e fundit, duke bërë realitet vendimet që u morën në Samitin e Uellsit dhe Varshavës.

Që nga viti 2014, NATO ka zbatuar përf forcimin më të madh të mbrojtjes kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë.

NATO është më shumë se një traktat

Udhëheqësit e NATO-s i kushtojnë memorial Murit të Berlinit dhe 11 shtatorit

Përpara takimit të liderëve të NATO-s më 25 maj 2017, Kancelarja gjermane Angela Merkel i kushtoi selisë së re të NATO-s në Bruksel, Memorialin e Murit të Berlinit dhe Presidenti i SHBA Donald Trump Memorialin e 11 Shtatorit në përkujtim të rënëve. Duke iu drejtuar liderëve aleatë, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se përmendoret treguan se “NATO gjithmonë do të mbrojë vlerat mbi të cilat është themeluar Aleanca jonë”.

Në fjalën e tij në kushtimin e e memorialit të 11 shtatorit dhe Neni 5, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, tha se “Forca më e madhe e NATO-s është lidhja e qëndrueshme midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Ne pamë forcën e kësaj lidhjeje pas sulmeve të 11 shtatorit kundër Shteteve të Bashkuara. Presidenti Trump, këto sulme goditën në zemër të qytetit tuaj të ri në Nju Jork. Dhe për herë të parë, NATO thirri klauzolën tonë të mbrojtjes kolektive, Neni 5.

Një për të gjithë, dhe të gjithë për një. Qindra mijëra ushtarë evropianë dhe kanadezë kanë shërbyer sup me sup me trupat amerikane në Afganistan për më shumë se një dekadë. Për të ndihmuar që ai të mos bëhet më një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë. Është solidariteti ynë që i mbrojnë kombet tona të sigurta. Dhe kur shoqëritë tona të hapura dhe të lira sulmohen, ne ngrihemi për vlerat tona dhe mënyrën tonë të jetesës. Kjo është arsyeja pse një NATO e fortë është e mirë për Evropën dhe e mirë për Amerikën e Veriut. Memoriali i 11 shtatorit dhe Neni 5 do të jetë një kujtesë e përditshme e lidhjes sonë jetike. Sot, ne do të angazhohemi për të bërë më shumë në luftën tonë të përbashkët kundër terrorizmit. Pra, zoti Kryetar, është një nder i madh që tju kemi këtu dhe një nder i madh për t’ju dhënë fjalën”.

Kurse fjalën e tij që mbajti në përkushtimin e Memorialit të Murit të Berlinit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg e nisi me fjalët se të dy memorialët kujtojnë të kaluarën e përbashkët. Ai tha se “Ne do të fillojmë takimin tonë me përkushtimin e dy përmendoreve. Mbledhja jonë sot është një mundësi për të përvijuar të ardhmen tonë të përbashkët. Dhe për të kujtuar të kaluarën tonë të përbashkët. Muri i Berlinit është një simbol i atij të fundit. Është ndërtuar për të ndarë Evropën. Të mbash njerëzit dhe idetë jashtë. Përballë ndarjes, aleatët e NATO-s ishin të bashkuar. Në mbrojtje të lirisë, demokracisë dhe dinjitetit njerëzor. Në vitin 1989, muri u rrëzua me protesta paqësore, nga lëvizjet popullore të tilla si Solidarność. Si dhe nga trimëria e burrave dhe grave të panumërta në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Çdo ditë, të gjithë ata që do të hyjnë në këtë ndërtesë do të kalojnë këtë memorial. Ata do të kuptojnë se liria kurrë nuk do të mposhtet. Dhe se NATO gjithmonë do të mbrojë vlerat mbi të cilat është themeluar Aleanca jonë. Kancelarja Merkel, ju ishit në Berlin natën kur Muri ra. Dhe për këtë arsye është një nder i madh t’ju mirëpresim këtu në Bruksel, në Shtabin e ri të NATO-s dhe kati është i juaji”.

Aleanca më e suksesshme ka një histori të suksesshme tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në fjalimin që mbajti në ceremoninë e dorëzimit të selisë së re



të NATO-s. Ai tha se “NATO është Aleanca më e suksesshme në histori për shkak të shërbimit dhe sakrificës së shquar të burrave dhe grave të forcave tona të armatosura, sepse qëndrojmë të bashkuar dhe sepse ne ndryshojmë kur bota ndryshon. Dorëzimi i selisë sonë të re shënon fillimin e një kapitulli të ri dhe dua të falënderoj kombin tonë pritës, Belgjikën. Mijëra njerëz nga anembanë Aleancës të cilët kanë kontribuar në këtë projekt dhe ata që po punojnë për të siguruar një tranzicion të qetë, tashmë në proces, nga shtëpia jonë e vjetër nëpër rrugë. Ky shtab do të jetë një simbol i një Aleance të fortë dhe të adaptueshme. Ai do të ofrojë lehtësira më moderne. Është një ndërtesë më e gjelbër, që na ndihmon të punojmë në mënyra të reja. Kjo është një selinë e shekullit të 21-të për një aleancë të shekullit 21.

NATO u themelua pothuajse 70 vjet më parë, për të mbajtur vendet tona të sigurta gjatë Luftës së Ftohtë.

Por ne jemi përshtatur vazhdimisht pasi sfidat e sigurisë kanë evoluar. Kur u rrëzua Muri i Berlinit, bota u ndryshua dhe kjo Aleancë gjithashtu ndryshoi. Ish-kundërshtarët u bënë partnerë, dhe pastaj aleatë. Dhe për herë të parë shkua përtej kufijve tanë, për të ndihmuar në përfundimin e luftërave etnike në Ballkanin Perëndimor. “Pastaj terroristët goditën në 11 shtator dhe bota u ndryshua përsëri. Dhe kështu bëmë edhe ne. Ne filluam operacionin tonë më të madh luftarak ndonjëherë, për të luftuar terrorizmin në Afganistan.

Në vitin 2014, ne pamë rritjen e një race të re barbare të terrorizmit dhe rendi i bazuar në rregullat ndërkombëtare u shkel. Kur kufijtë u ndryshuan me forcë ushtarake në Ukrainë. Edhe një herë, NATO u përgjigj. Me përforcimin më të madh të mbrojtjes tonë kolektive në Evropë në një brez. Jo sepse ne përpiqemi të mos provokojmë konflikt, por sepse duam të parandalojmë konfliktet dhe të ruajmë paqen. Kjo është arsyeja pse edhe ne mbetemi të angazhuar për dialog, ndërkohë, ne kemi rritur rolin tonë në luftën kundër terrorizmit. Ne kemi qenë në vijën e parë të asaj lufte për shumë vite. Dhe ne vazhdojmë të ndihmojmë partnerët tanë në Afganistan, Irak dhe vende të tjera për të ndërtuar forcat e tyre dhe për të stabilizuar vendet e tyre. Me afirmimin e NATO-s në një botë të pasigurt, gjithmonë ka qenë një konstante: uniteti ynë. Gjatë gjithë historisë, ne kemi qëndruar së bashku”.

Duke iu referuar sulmit barbar në Manchester, Stoltenberg tha se “ky sulm tregon se sa e rëndësishme është që ne të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku në mbrojtje të shoqërive tona të hapura”, prandaj aleatët në takim vendosën se çfarë duhet të bëjnë më shumë për të mbajtur “aleatët tanë të sigurt në një botë më të rrezikshme. 28 aleatë, së shpejti do të jenë 29, ndërsa ne përgatitemi për pranimin e Malit të Zi si anëtar i ri i NATO-s”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai i uroi mirëseardhjen, kryeministrit Marković në Shtabin e NATO-s, “Prandaj është një nder i madh për mua t’ju mirëpres sot Kryeministri Marković i Malit të Zi në familjen tonë euroatlantike. Dobrodošli Carna Gora. NATO është më shumë se një traktat. Më shumë se një organizatë. NATO mishëron lidhjen unike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Dhe, ndërsa ngremë flamuj sot ... Në këtë moment përcaktues për sigurinë tonë ... Aleanca jonë qëndron e fortë, e bashkuar dhe e vendosur”.

Përktheu HERION KËRCELLI

Gjeneral Kelly, dua t'ju falenderoj juve për si Sekretar i Shërbimit të Rojes Bregdetare të SHBA. Ju keni qenë me të vërtetë shumë i vecantë për shtetin tonë,për mua dhe administratën tonë. Ju keni bërë përgjatë gjithë jetës tuaj një punë të pabesueshme duke mbrojtur vendin tonë. Të falemnderit shumë, John.Johni dhe të gjithë njerëzit e tij janë duke bërë gjithashtu një punë të pabesueshme duke mbrojtur atdheun tonë dhe kufirin tonë. Jam shumë i emocionuar që adresa ime e parë në Akademinë e Shërbimit është ceremonia e diplomimit për Rojen Bregdetare të Shteteve të Bashkuara. Me besoni, është një nder i madh. Unë kam qenë këtu më parë dhe është një vend shumë, shumë special. Çdo kadet që diplomohet sot, si Kryekomandanti juaj, është me të vërtetë nderi im që ta mirëpres në bord. Dhe ju duhet të merrni një moment që të festoni këtë arritje të pabesueshme.

Governator Malloy, {guvernatori i CT, shënimim} faleminderit që jeni këtu. Ne jemi të kënaqur që ju mundet të bashkoheni me ne. Dhe une e di sa të zënë janë guvernatorët sot, dhe ata janë atje duke luftuar. Nuk është kurrë e lehtë. Buxhetet janë pak të ngushtë, por ne jemi duke bërë një punë, të gjithë jemi duke punuar së bashku. Gjithashtu falenderoj Admiralin Zookunft dhe udhëheqjen e tij. Udhëheqja e tij ka qenë mahnitëse. Të diplomuarit e sotëm janë me fat qëdo i shërbejnë nën një Komandant aq të zot dhe me eksperiencë. Ai është megjithëmend fantastik.Falenderime gjithashtu ndaj Admiralit Rendon, Inspektorit të Akademise. Admiral, unë e kuptoj që ju vini nga një familje e vërtetë e Rojes Bregdetare. Dy vëllezër, një nip, një kushëri, të gjithë kanë kaluar përmes këtyre koridoreve. Ajo është shumë mbresëlënëse. Them se e pëlqen vendin, apo jo? Dikush në familjen tuaj ka qenë duke bërë dicka të drejtë. Unë mund ta tregoj atë. Jam i sigurtë që ata janë të gjithë shumë krenarë, thjesht sic jemi ne krenarë për oficerët e rinj, që janë duke u diplomuar sot, Admiral, nën mbikqyrjen tuaj.

Unë gjithashtu. do të doja të shfrytëtoj këtë rast, për të shprehur mirënjohjen tonë ndaj të gjithë prindërve, gjyshërve dhe anëtarëve të familjes që kanë mbështetur këta të diplomuar mahnitës. Jepini prindërve dhe cdokujt një dore. Eja. Meqë Amerika ka familje si këto, dhe ne do të mbajmë të gjitha këto familje të siguruar dhe tepër, tepër të sigurta. Ju, po i mbani familjet tuaja të sigurta tani. Në qoftë se nuk jeni tashmë, ju jeni për tu bërë familje ushtarakesh. Kështu, duke filluar nga sot, unë shpresoj se, ju e ndjeni mirënjohjen e plotë të kombit tonë. Këta kadete të mirë të rinj janë për marrë vendin e tyre të ligjshëm në vijën mbrojtëse të frontit të SHBA.

Kadetë, ju nuk meritoni vetëm urimet, por edhe mirënjohjen e secilit dhe cdo Amerikani. Dhe ne të gjithë ju nderojmë ju me kokë. Një komb krenar. Dhe ju jeni një pjesë e një kombi tepër krenar, që nderon me kokë kadetët 195 199, të Klasës 2017 të Akademisë së Rojes Bregdetare.Unë e kuptoj nga admiralët që kjo ka qenë një klasë tepër speciale. Ju jeni trajnuar këtu të menaxhoni situata e momente të vështira, që duan një farë experience. Do përballoini momente të vështira në jetën e njerzve dhe të ndihmoni të dobëtin në orën e tyre të nevojës. Por, madje edhe për Rojen Bregdetare, kjo klasë ka qenë në mënyrë të vecantë e dedikuar ndaj shërbimit publik.Ju shërbyet mëngjes tek banka e ushqimit lokal një ditë të vetme në javë. Ju rindërtoat një shtëpi me banesa për njerzit. Vitin e kaluar, ju udhëhoqët kadetët në dhurimin e një totali prej 24,00 orësh-një kohe e gjatë-ndaj shërbimit të komunitetit. Ju keni bërë punë mahnitëse. Në raport me vitet e tjera të Rojes Bregdetare, ju keni pasur më pak njerëz dhe më pak resurse, por ju i arritët objektivat. Ju e bëtë atë me aftësi dh me krenari dhe, do të doja të thoja, me buxhet më të vogël dhe para orarit. Ne po bëjmë shumë prej saj tani në qeverinë e Shteteve të Bashkuara.

Unë nuk do ju flas juve për sa shumë kurseva ju mbi motorin reaktiv luftues F-35. As nuk do të flas për atë. Ose sa shumë ne jemi për të kursyer juve mbi aeroplanmbajtjen Gerald Ford. Ajo kishte një problem teprice përpara se unë të vijja këtu, ju e dini atë. Akoma do të ketë një problem teprice. Ne hymë brenda kur kishte përfunduar. Por ne do të kursejmë mjaft para. Dhe kur ne ndërtojmë aeroplanmbajtëse të reja ato do tëndërtohen poshtë buxhetit dhe pra kohe. Këtë thjesht mbajeni mend. Ajo do të na lejojë ne të ndërtojmë më shumë. Tani, sigurisht, ka gjithmonë disa gabime nga koha në kohë-ju e dini atë. Për shembull, unë kuptoj që një herë ose dy herë, Kadeti i Klasës së Parë Bruce Kim. Ku është Bruce? Oh, Bruce, si ja bën ti këtë vetes, Bruce? Si Oficer Regjimental i Parkimit, mund të ketë plotësuar aksidentalisht disa bileta për ti lëshuar ose disa makina tuajat janë për tu nisur. Bruce, çfarë po ndodh me ty? Por, Kadetë, që nga kjo ditë e tutje, ne duam që të gjithë të jenë të pastër shpirtërisht në jetë. Kjo përfshin dhe Bruce, apo jo? Dhe kështu, për ndonjë pavëmendje ose thyerje të vogla që mund të kenë ndodhur këtë vit, sic kërkon tradita, unë në këtë mënyre shfaqësoj cdo kadet duke justifikuar krimet e vogla. Tani, Bruce-ngrihu në këmbë edhe një herë, Bruce.

Akademia e Rojes Bregdetare New London, Connecticut

Kadetë, ju meritoni mirënjohjen e çdo Amerikani

Fjala e Presidentit Trump në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të Rojes Bregdetare të SHBA



Ata të shpëtuan ty, Bruce, sepse ata të gjithë duan që unë ta bëj atë, dakort? Faleminderit, Bruce. Urime, Bruce. Ju lumtë. Me që ra fjala, Bruce, mos u shqetëso për atë. Ajo është tradita. Unë isha i detyruar ta bëja atë. Ti e di. Mos u shqetëso.

Ky është me të vërtetë një grup i mahnitshëm i kadetëve që janë këtu sot për urdhër gradimi. Ju mund të kishit shkuar për shkolim kudo që donit, dhe më shumë, shumë pak përgjegjësi në krahasim me këtu Por në vend të saj, ju zgjidhët rrugën e shërbimit. Ju zgjidhët punën e vështirë, standardet e larta, dhe një mision tepër fisnik,të shpëtoni jetë, të mbronni atdheun, të mbronni interesat e Amerikës rreth globit. Ju zgjidhët Rojen Bregdetare. Zgjedhje e mirë. Zgjedhje e mirë. Ju keni mësuar aftësi që të tjerët nuk i mësojnë në shkollat e tjera. Kjo është specifikë e kësaj akademie, por dhe kampi juaj i madh, deti i hapur i madh. Ai eshte nje kamp i madh, i madh, apo jo? Një kamp i bukur. Por dija që keni mësuar tek ky institucion krenar, është dija ju keni mësuar për detyrën e veten tuaj. Është dija që e bën secilin prej jush drejtues të vlefshëm në cdo situatë.

Nga ditët e para me stuhi të Swab Summer (Vere Shtupe), deri tek klasat finale, si nje kadet i klasës së parë, secili prej jush është pritur që të marrë përgjegjësi, të merrni vendime, dhe të vepronin. Të bëni gjënë e duhur. Dhe ju duhet të mësoni të vepronin në rrethana të ndryshme dhe nën presion tëmadh. Vetëm pak ditë nga tani, ju do ta vendosini këtë aftësi jetike nën shërbimin e anijeve tuaja, sektorëve, dhe vendit tuaj. Ju do të shërbeni si oficerë të kuvertës në anijet e patrullimit të Rojes sonë Bregdetare. Ju do të forconi ligjin dhe urdhërin në ujërat e rrezikshme, si oficerë lundrues. Ju do të bllokoni transportimin e paligjshëm të parave, armëve dhe drogës. Ju do të lufton trafikimit të qënieve njerëzore-dicka për të cilën njerëzit nuk kanë folur shumë. Një nga murtajat e mëdha të botës. Ju vetëm vendi ynë, por krejt bota. Amerikanet do ta vendosin besimin e tyre në udhëheqjen tuaj, komandantët tuaj do t'ju besojnë juve gjithashtu. Roja Bregdetare është standard i artë në delegimin e vendimmarrjes sipas zinxhirit komandues. Kështu thjesht sic instruktorët tuaj vepruan tek akademia, komandantë e Rojes Bregdetare do t'ju shpejgojnë vizionin e tyre, dhe pastaj do t'ju besojnë ju që të bëni punën. Thjesht ashtu si unë, si Presidenti juaj, do ju besoj ju që të bëni punën.

Është e mahnitshme të mendosh për aventurat që janë duke filluar për ju. Në gjithë vendin, këtë muaj, miliona studente janë duke u diplomuar nga shkolla e mesme, universiteti. Shumë të tjerë merakosen, thjesht çfarë do të bëj. Ata i thonë vetes, çfarë do të bëjnë? Ju e dini çfarë do të bëni. Ju morët një profesion të mirë, meqë ra fjala. Ju morët një të bukur, një të mirë. Dhe ne jemi megjithmend krenarë t'ju kemi ju pranë.Vite më pas, disa prej jush mund të shikojnë mbrapa dhe të pyesin veten, nëse kanë bërë zgjedhjen e duhur, nëse kanë

bërë shumicën e mundësive që i janë dhënë. Në Rojen Bregdetare, ju do të përballemi me shumë sfida dhe shumë kërcënime. Por, një gjë që ju kurrë nuk do t'ju duhet të përballemi më, është pyetja se, çfarë do të bëj. Kur të shihni mbrapsht, nuk do të dyshoni. Ju e dini egzakhtësisht si e keni kaluar kohën tuaj-duke shpëtuar jetë.

Këtë e hikoj tek ju admiralë, tek Gjeneral Kelly, tek disa njerëz të mëdhenj në shërbim. Unë ju them se ata e duan atë që bëjnë. Ata e duan vendin. Ata duan ta mbrojnë vendin tonë dhe ata e duan çfarë bëjnë. A nuk është e drejtë? Mirë. Unë nuk mendoja se ndonjë do të thoshte jo. Ajo do të prishte fjalimin tonë, apo jo? (Të qeshura). Ata janë njerëz të mëdhenj. Ju gjithmonë e dini çfarë do të bëheni: liderë dhe oficerë të Rojes Bregdetare të Shteteve të Bashkuara. Dhe kur të shohin uniformën tuaj, cdokush në botë, do ta dije egzakhtësisht çfarë do të thotë. Çfarë standardi?-dhe me të vërtetë nëse mendon për atë, kur ju flisni për marinarët e mëdhenj, dhe marinarët më të mëdhenj të botës, ne i kemi. Por nuk ndjejmë lehtësim për marinarë të ngecur në cekëtinë, ndërsa gradat e tyre të rangut të lartë, plot vezullim thejnëjnë horizontin? Çfarë është një shpirt endacak në det, me vetëm një kohë të shkurtër jete, që nuk gëzohet tek tingulli i atyre teheve të hanxhareve lart, duke ardhur mbrapsht dhe duke zbritur poshtë që ti shpëtojë ata nga vdekja? Çfarë është kontrabandisti i drogës, një shitës helmi, i cili rri gjithë frikë nga kamzhiku i vendit tonë, nga fuqia e Rojes Bregdetare. Në këtë rast, ne e dimë arësyeën,- shërbimi jetëshpëtues i Amerikës është në rrugë e sipër. Roja Bregdetare është me të vërtetë jetike për Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara dhe në të vërtetë jetike për vendin tonë të madh.

Nga pesë degët e Shërbimeve tona të Armatosura, është vetëm Roja Bregdetare që ka pushtetin të thejëjë përmes 21 feet(këmbë) të akullit Arktik, të fortë shkëmb, apo jo? Ju jeni të vetmit. Dhe unë jam krenar të them që nën administratën time, ne jemi duke ndërtuar të parët akullthyes të rinj të rëndë që Shtetet e Bashkuara kanë parë në mbi 40 vjet. Ne do të ndërtojmë shumë prej tyre. (Duartrokitje). Na duhen. Na duhen. Roja Bregdetare mban në ruajtje portet tona, patrullon kanalet tonë të lundrueshëm, dhe mbron infrastrukturën tonë. Ju mbronni Amerikën në një botë të kërcëni-meve massive dhe të rënda. Së shpejti, disa prej jush do të jenë duke drejtuar bordimin e anijeve të dyshimta, duke kërkuar për armët më vdekjeprurëse, dhe duke mbajtur nën arrest kriminelë të rrezikshëm. Me një qëllim. Për ta mbajtur popullin tonë të sigurtë. Të tjerë prej jush do tëshërbejnë me partnered e vendeve të tjera rreth globit, duke sjellë pushtetin e plotë të Rojes Bregdetare të Shteteve të Bashkuara drejt e tek ato brigje të largëta. Dhe disa prej atyre brigjeve janë shumë larg.

Që të sigurojmë kufijtë tonë nga kartelat e drogës, kontrabandistëve të qënieve njerëzore,

dhe kërcënimeve terroriste. Anijet e Patrullimit të Rojes Bregdetare patrullojnë më shumë se 1,500 milje poshtë kufirit tonë jugor. Shumë njerëz nuk e dinin atë. Kur krenaria e pamasë godet zemrën tënde, ti kupton që me ketë aftësi të madhe dhe shpejtësi të tmerrshme, burrat dhe gratë e Rojes sonë Bregdetare ndalojnë kriminelë të rrezikshëm dhe miliarda dollarë vlerë të narkotikëve të jashtëligjshëm cdo vit të vetëm. Helikopterët tuaj lancojnë nga ku-vertat e anijeve të patrullimit të klasit botëror, dhe ata ndjekin kontrabandistët e drogës me shpejtësi në më tepër se 50 nyje. Në dete të ashpër, me shpejtësi të mëdha, snajperat tanë të pabesueshëm të Rojes Bregdetare marrin shenjë tek motorrat e kontrabandistëve. Dhe kohë pas kohë, ata nxjerrin motorrët në goditjen e parë. Atyre nuk i pëlqen të shpërdorjnë fishekët, apo jo? (Duartrokitje). Detyra juaj përmes stuhive ulëritëse, dhe përmes shiut që kap cdo pjesë të anijes, dallgëve që përplasen nga bashi në kic, është një vend ku pak njerëz të tjerë do donin të rrezikonin. Shpeshherë me rrezik dhe ndonjëherë-emocionuese. Emocionuese. Por duhet ta kesh në zemer. Ju duhet ta duani atë. Ju e doni.

Në Rojen Bregdetare, ju nuk vraponi nga rreziku, ju e ndiqni atë. Dhe ju jeni pozicionuar për mbështetjen e operacioneve në teatrat e konfliktit rreth gjithë botës. Por jo vetëm që ju mbronni sigurinë Amerikane, ju gjithashtu mbronni mirëqënien Amerikane. Është një mision që shkon mbrapa që herët dhe Anijeve të Patrullimit të të Ardhurave. Ju keni lexuar për atë dhe e keni studiuar mirë. Sot, Roja bregdetare ndihmon të mbajë ujërat tanë të hapur për Amerikanët që të bëjnë biznes. I mban lumenjtë tanë ku zhvillohet tregëtia lumore. I mban portet tanë tepër eksportet Amerikane. Ju ndihmoni miliarda e miliarda dollare në të mira materiale që të të transportohen cdo ditë në vendin tonë. Ju jeni e vetmja prezence federale mbi lumenjtë e lundrueshëm të brendshëm. Ju patrulloni arteriet që ne kemi nevojë të rindërtojmë këtë vend dhe tëpërmirësojmë mirëqenien tonë. Dhe ne jemi duke e bërë këtë. Ju mund ta shihni atë. Mendoni për misionin e lavdishëm që ju pret. Ne do të sigurojmë portet tona, lumenjte tanë të lundrueshëm, dhe kufijtë tanë. Ju do të jeni partnerë me aleatët tanë që të avancojmë interesat e sigurisë brenda dhe jashtë vendit. Dhe ju do të ndiqni terroristët, ju do të ndaloni kontrabandistët e drogës, dhe ne do të kërkojmë që të mos hyjnë të gjithë ata që do të dëmtonin vendin tonë. Të gjithë ata që nuk e duan vendin tonë.Së bashku, ne kemi të njëjtin mision, dedikimi dhe devotshmëria juaj më bën me të vërtetë krenar të jem Kryekomandanti juaj.

Tani, unë dua ta marr këtë mundësi, për tju dhënë juve disa këshilla. Gjatë rrjedhës së jetës tuaj, ju do të gjeni që gjërat nuk janë gjithmonë të drejta. Ju do të hasni gjëra që nuk i meritoni dhe që nuk janë gjithmonë të garantuara. Por ju duhet të ulni kokën dhe luftoni, luftoni, luftoni. Kurrë, kurrë, kurrë mos hiqni dorë. Gjërat do të zgjidhen thjesht mirë.Shikoni tek mënyra si jam trajtuar kohët e fundit-vecanërisht nga media. Asnjë politikan në histori-dhe unë e them këtë me siguri të madhe-ka qenë trajtuar më keq apo më me pa të drejtë. Ju nuk mund ti leni kritikët dhe pesimistët të hyjnë në rrugën e ëndrrave tuaj. Prandaj unë-ju falenderoj. Mendoj se prandaj ne fituam. Fatqëësia të bën më të fortë. Mos u dorëzoni. Mos zbrisni mbrapa. Dhe kurrë mos ndaloni së bëri, çfarë ju e dini që është e drejtë. Asgjë që vlen nuk vjen lehtë. Dhe sa më e drejtë të jetë e drejta juaj, më shumë kundërshtime do të përballemi me të. Unë kam realizuar mjaft për një kohë të shkurtër si President. Duke shkelur gjithë vendin. Një drejtësi e Gjykatë Supreme fare e re-që do të jetë fantastike për 45 vjet. Një investim historik në ushtrinë tonë. Ne kemi ruajtur Amendamentin e Dytë, kemi zgjeruar shërbimin për veteranët tanë-ne do të kujdesemi për veteranët tanë si kurrë më parë.

Unë kam shtendosur zinxhirët mbytës të mjedisit që mbulojnë rreth vendit tonë dhe ekonomise tonë, zinxhirë aq të ngushtë që nuk mund të bëjë asgjë-që punët po pakësoheshin. Ne ishim duke humbur biznes. Ne po e shtendosim. Ne kemi filluar planet dhe përgatitjet për murin e kufirit, që po shkon shumë, shumë mirë. Ne po punojmë për shkurtimin e taksave të mëdha për të gjithë. Ne do ju japim juve shkurtimin e taksës më të madhe në historinë e vendit tonë, nëse e marrin në menyren qe duam, dhe do t'ju japim juve reformën më të mirë të taksave. Dhe ne, gjithashtu jemi duke shkuar afër dhe më afër, dita ditës, ndaj një kujdesi shëndetsor për qytetarët tanë. Ne jemi duke vendosur për shume cështje jetike të së ardhmes. Njerëzit e kuptojnë atë që po bëj unë, dhe kjo është gjeja më e rëndësishme. Unë nuk u zgjodha ti shërbej medias së Ëashingtonit ose interesave speciale. Unë u zgjodha që ti shërbej burrave dhe grave të vendit tonë, dhe ajo është çfarë po bej. Unë nuk do të pushoj kurrë së luftuari për ju, dhe nuk do të pushoj kurrë së luftuari për popullin Amerikan.Sic e lini këtë akademi që të hipni mbi lundrimin e ri emocionues, unë jam duke u përgatitur për një udhëtim shumë të domosdoshëm gjithashtu. Në pak ditë, unë do të bëj udhëtimin tim të parë jashtë shtetit si President. Me siguri, sigurim, dhe interesat e popullit Amerikan si prioritetin tim, unë do të forcoj miqësitë e vjetra dhe do të kërkoj partnerët rinj.por partnerë që gjithashtu na ndihmojnë neve. Jo partnerë që marrin dhe marrin... partnerë që bashkëpunojnë, partnerë që ndihmojnë të paguajnë për çfarëdo ne jemi duke bërë dhe të gjithë të mirën që ne jemi duke bërë për ata,që është dicka që shumë njerëz nuk janë mësuar dhe ata thjesht nuk mund të mësohen. Une them, mesohuni me atë, njerëz. Unë do ti kërkoj atyre të bashkohen për një të ardhme të paqes dhe mundësinë e opozitës për njerëzit tanë dhe njerëzit e botës.


Së pari, në Arabinë Saudite, ku unë do të flas me liderët Myslimane dhe ftoj ata të luftojnë urrejtjen dhe ekstremizmin, dhe të përqafojnë një të ardhme të paqtë për besimin e tyre. Dhe ata mezi po presin të dëgjojnë çfarë ne si përfaqësuesit tuaj duhet tu themi. Ne duhet të ndalojmë terrorizmin Islamik radikal. Pastaj në Izrael, unë do të riafirmoj aleancën tonë të pathyeshme me shtetin Hebraik. Në Romë, unë do të flas me Papa Franceskun rreth kontributeve të besimit të Krishterë ndaj botës. Më në fund, unë do të marr pjesë në Samitin e NATO-S në Bruksel dhe takimin eG-7, në Sicili,që të promovoj sigurimin, mirëqënien dhe pagen kudo në botë.Unë do të takoj këta lidera, dhe do nderoj vendodhjet më të shenjta të këtyre tre feve të mëdha. Dhe kudo që do shkoj, unë do të marr frymëzimin tuaj. Unë mar nga ju cdo ditë, nga guximi dhe vendosmëria juaj për të bërë çfarëdo është kërkuar që të siguroj dhe mbroj jetët Amerikane. Të siguroj dhe mbroj jetët Amerikane. Ne duam siguri. Ju do të na jepni ne sigurim. Në vetëm një shembull, ne shohim si ja ktheni cdo ditë vlerën jetës për njerëzit që ju takoni cdo ditë. Disa vite me parë, një helikopter i Rojes Bregdetareshpëtoi tre peshkatarë, që të tmerruar kapeshin pas anijes së tyre, qëpo mbyteshe dhe po digjeshe. Atë ditë, heronjtë e Rojes Bregdetare e bënë detyrën e tyre mirë. Ata fluturuan ngjitur me detin, pavaresisht rrezikut të tmerrshem, dhe zgjaten një dorë ndihme ne momentin e duhur. Kishte mbetur shumë pak kohe.

Por ajo nuk është pjesa më e shquar e asaj historie. Çdo pjesëtar, si një notues i Rojes Bregdetare e vendos ate, ju e beni atë gjë gjithë kohës, në cdo orë të ditës. Dicka ndodh gjithë kohën me Rojen Bregdetare të Shteteve të Bashkuara. Ju bëni një punë mahnitëse. Një gjë e pazakontë ndodhi me atë shpëtim, por kur ju mendoni për atë, ju i bëni ato shpëtime gjithë kohës. Në një rast tjetër, kapiteni i një peshkatoreje vietnameze mori dorën e notuesit. Ai e pa shpëtuesin e tij të Rojes Bregdetare në sy, dhe tha: “Unë isha duke i kërkuar Zotit të më linte të jetoja.... Unë kam nevojë të shikoj fëmijët e mi. Të lutem, Zot, më lër të jetoj që të mund të shoh fëmijët e mi. Pastaj Zoti të dërgoi ty.” Ajo është çfarë tha.

Për qdo oficer të ri, dhe për qdo antar të ri të Rojes Bregdetare këtu ose jashtë,që sot është duke mbrojtur jetë rreth botës mbi disa prej ujërave më të ashpër ndokund, ju me të vërtetë po bëni punën e Zotit. Çfarë zemre mirënjohëse keni nga të gjithë. Sepse është dhe në zemren time tepër mirënjohese, dhe gëzimet e Amerikës për Rojen Bregdetare, dhe Amerika gëzohet për ju shpesh, por ne ju urojmë juve fat të mirë.

Si Kryekomandanti juaj, unë ju falenderoj. Unë ju nderoj me kokë. Dhe unë, edhe një herë përsëri, përgëzoj Grupin e Rojes Bregdetare të 2017-ës. (Duartrokitje). Zoti ju bekoftë. Zoti bekoftë Rojen Bregdetare. Dhe Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Faleminderit shumë. Faleminderit. (Duartrokitje). Falemnderit të gjithëve. Nder i madh. Paci fat. Shijojeni jetën tuaj. (Duartrokitje).

Shtëpia e Bardhë
Zyra e Shtypit
17 Maj 2017



Ministri Demolli falënderoi në veçanti ministrin Isik për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria turke e Mbrojtjes po jep për FSK-në, si në fushën e arsimit, me anë të programeve të ndryshme për shkollimin dhe trajnimin e kuadrove ushtarake dhe civile, ashtu edhe në mbështetjen me donacione dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore për trajtimin e pjesëtarëve të FSK-së në Qendrën Spitalore të Ushtrisë së Republikës së Turqisë.



HAKI DEMOLLI-FIKRI ISIK

Bashkëpunim ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë turke

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), zotëri Haki Demolli, zhvilloi një takim në Stamboll me Ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik, gjatë qëndrimit të tij në panairin e 13-të Ndërkombëtar të Mbrojtjes (IDEF 2017), në Turqi.

Në takimin e përbashkët, ministri Demolli dhe ministri i Mbrojtjes të Turqisë zotëri Isik folën për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë si dhe për bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë turke në përgjithësi.

Ministri Demolli e falënderoi në veçanti ministrin Isik për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria turke e Mbrojtjes po jep për FSK-në, si në fushën e arsimit; me anë të programeve të ndryshme për shkollimin dhe trajnimin e kuadrove ushtarake dhe civile, ashtu edhe në mbështetjen me donacione dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore për trajtimin e pjesëtarëve të FSK-së në Qendrën Spitalore të Ushtrisë së Republikës së Turqisë.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik shprehu gatishmërinë e Turqisë për ta vazhduar bashkëpunimin e



plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së si institucion për

të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Në takim, Ministri shoqërohej nga këshilltari ushtarak i tij, kolonel

Fadil Hadergjonaj si dhe atasheu i FSK-së në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani.

Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik shprehu gatishmërinë e Turqisë për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë.

FSK operon sipas standardeve të NATO-s

Procesi i transformimit do jetë transparent dhe në koordinim me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneral lejtënant Rrahman Rama priti në takim në Ministrinë për FSK, anëtarin e Kongresit të SHBA-ve, republikanin nga Ajova, zotëri Steve King. Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës dhe kongresistit King u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërmjet SHBA-së dhe Kosovës, bashkëpunimin e mirë ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Ajovës dhe në veçanti për bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet FSK-së dhe Gardës

Kombëtare të Ajovës dhe Ushtrisë amerikane në përgjithësi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, e njoftoi kongresistin King për zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe për progresin e saj në aspektin e nderveprueshmërisë me të gjithë partnerët, sipas standardeve të NATO-s. Gjithashtu, gjeneral Rama e njoftoi anëtarin e Kongresit Steve King edhe mbi planet strategjike për zhvillimin e

Forcës së Kosovës, konkretisht mbi synimin e shtetit të Kosovës që FSK-ja të transformohet në Forcë të Armatosur, me mision dhe detyra të mbrojtjes së vendit.

Gjeneral Rama e siguroi kongresistin King se FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet, është plotësisht e gatshme për transformim, dhe pret vendimmarrjen politike të institucioneve më të larta të shtetit. Gjithashtu, gjeneral Rama ritheksoi që i gjithë procesi i transformimit do të jetë transparent dhe në koordinim me partnerët strategjikë të Republikës së Kos-

ovës. Nga ana e tij, kongresisti amerikan Steve King shprehu gatishmërinë e SHBA-së për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Gjithashtu, kongresisti King shprehu përkushtimin për të lobuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Ajovës dhe Kosovës në të gjitha fushat me interes të përbashkët.




"Kapiten Karriere"

Kapiten Mentor Ibrahim i oficeri më i mirë ndërkombëtar në SHBA

Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), Mentor Ibrahim, pjesëtar i Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, u shpall oficeri më i mirë ndërkombëtar në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kapiten Ibrahim që nga shtatori i vitit 2016 e deri më 18 maj 2017 ka marrë pjesë në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjenerata 17-1, dhe prej të gjithë oficerëve nga shtete të ndryshme u shpall më i miri. Kapiten Mentor Ibrahim gjatë shkollimit të tij në Kursin e Karrierës për Kapiten të Këmbësorisë në Qendrën e Ekselencës (Maneuver Center of Excellence) në Fort Benning të SHBA-ve, ka shfaqur performancë të jashtëzakonshme në fushat, si: Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake, Terminologjia dhe Grafika Ushtarake dhe në Doktrinën Amerikane në përgjithësi. Ndërkaq, pas përfundimit të kursit, Kapiten Karriere, kapiteni Mentor Ibrahim shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, me ç'rast nga komandanti i kursit gjeneral major Eric Wesley, si shenjë mirënjohjeje për arritje të jashtëzakonshme, i dhurohet libri me përmbajtje ushtarake "Fjalë për luftëtarët".





Në gjeneratën e tetë nga gjithsej 80 të paraqitur janë selektuar gjashtë kandidatë të cilët përfunduan me sukses të gjitha testet selektuese dhe u graduan me statusin kadet. Shkollimin për pilot ushtarak në mënyrë teorike dhe në atë praktike me 10 fluturime me aeroplanin ZLIN-242L kandidatët do ta kryejnë sipas standardeve të NATO-s.



Shkollimi i pilotëve ka rëndësi për ushtrinë e Maqedonisë

Zoran Jolevski, në adresimin e tij në fillimin e stërvitjeve të shkollimit për pilotë ushtarak deklaroi se shkollimi për pilotë ushtarak ka një rëndësi të madhe për kandidatët personalisht, por edhe për ushtrinë maqedonase.

Nga data 15 maj 2017, në Qendrën për Stërvitje të Pilotëve në kazermën "Strasho Pinxhur" në Petrovec fillojnë stërvitjet e gjeneratës së tetë të kandidatëve për pilotë ushtarakë, stërvitje të cilat parashikohen të mbahen në një periudhë 18 mujore.

Në gjeneratën e tetë nga gjithsej 80 të paraqitur janë selektuar gjashtë kandidatë të cilët përfunduan me sukses të gjitha testet selektuese dhe u graduan me statusin kadet. Shkollimin për pilot ushtarak në mënyrë teorike dhe në atë praktike me 10 fluturime me aeroplanin ZLIN-242L kandidatët do ta kryejnë sipas standardeve të NATO-s.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski, në adresimin e tij në fillimin e stërvitjeve të shkollimit për pilotë ushtarak deklaroi se shkollimi për pilotë ushtarak ka një rëndësi të madhe për kandidatët personalisht, por edhe për ushtrinë maqedonase.

"Ky trajnim ka një kuptim të fuqishëm si për kandidatët personalisht ashtu edhe për Armatën e Maqedonisë. Ata do të kenë mundësinë të edukohen në njërin ndër qend-



rat për stërvitje të pilotëve me bashkëkohore në Evropë, ndërsa në këtë pjesë të Evropës sigurisht që kjo është qendra më bashkëkohore. Kemi numër të madh të pilotëve të interesuar nga vende tjera, që vijnë këtu për të shfrytëzuar simulatorët tanë", tha Jolevski. Ndërkaq, drejtor i Qendrës për Stërvitje të Pilotëve, Jaari Shraga, shprehu bindje se këta gjashtë kandidatë të selektuar nga ekipi i tij do të kryejnë me sukses shkollimin për pilot ushtarak dhe do të diplomohen si pilot të kualifikuar ushtarak.

"Ne do t'u japim juve të gjitha nevojat, përfshirë mjetet dhe stafin profesional

pa marrë parasysh atë teknik, instruktorë fluturimi apo administratorë. Kështu që gjithçka është në duart tuaja, varet nga ju a do t'ju shohim në qershor të vitit 2018 të diplomuar nga kjo qendër", u shpreh Shraga, duke shtuar se këto kandidatë do të trajtohen në përputhje me standardet e larta të NATO-s.

Ndryshe, Qendra për Trajnim të Pilotëve e dedikuar për selektim dhe trajnim të pilotëve për nevojat e Armatës së Republikës së Maqedonisë është formuar sipas shembullit dhe standardeve të akademisë së lundrimit të Aviacionit ushtarak izraelit.

SHBA, 115 milionë USD për pajisje dhe shërbime

Ministrat e Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme, Zoran Jolevski dhe Nikolla Popovski, më 11 maj 2017, në kazermën "Ilinden"-Shkup, ishin të pranishëm gjatë vizitës së delegacionit të lartë të Kongresit amerikan në Batalionin e Policisë Ushtarake.

Delegacioni i përbërë në kongresmenëve i udhëhequr nga kongresisti Bob Goodley i cili është Kryetar i Komitetit Gjyqësor patën mundësi të mësojnë në lidhje me aktivitetet e Batalionit të Policisë Ushtarake dhe pjesëmarrjen e tyre të mëparshme në misionet paqeruajtëse.

Ministri Jolevski në fjalimin e tij para Kongresit dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit ka falënderuar për mbështetjen dhe ndihmën e SHBA-ve në drejtim të pajisimit, pjesëmarrjes në trajnime dhe stërvitje në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë mbrojtëse të Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe theksoi se bashkëpunimi i deritanishëm i lartë me SHBA do të vazhdojë edhe më tej. "Ky bashkëpunim i cili del nga Marrëveshja për Partneritet Strategjik dhe Bashkëpunim nga viti 2008 dhe Memorandumit për Bashkëpunim në Mbrojtjen dhe Marrëdhëniet Ushtarake nga viti 1994, si dhe bashkëpunimi me vendet e tjera të NATO-s kanë mundësuar që sot ne të kemi pjesëtarë të Ushtrisë që qëndrojnë krah për krah me ushtri të tjera dhe që janë të gatshëm për të kontribuar për paqen dhe sigurinë globale" - shtoi Jolevski. "Republika e Maqedonia ka një qëllim të përcaktuar qartë, që është anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO," - tha ministri Popovski. Ai shtoi se anëtarësimi është i rëndësishëm sepse i njëjti do të kontribuojë në zhvillimin e Maqedonisë dhe vendeve të tjera në rajon dhe do të kontribuojë në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë së qytetarëve, dhe me këtë edhe në një rajon



stabil dhe një Evropë stabile.

Kongresmeni Goodley shprehu kënaqësinë nga prezantimi dhe vuri në dukje se ata çmojnë përpjekjet e Maqedonisë në promovimin e paqes dhe sigurisë përmes pjesëmarrjes në misionet paqeruajtëse në Irak dhe Afganistan. Ushtarët maqedonas kanë fituar reputacion të lartë në mesin e partnerëve dhe aleatëve që marrin pjesë në misionet paqeruajtëse. Ai shtoi se Batalioni i Policisë Ushtarake dhe njësitë e tjera të Armatës së Republikës së Maqedonisë demonstrojnë një nivel të lartë të profesionalizmit duke ruajtur kufijtë e Maqedonisë dhe sigurinë e qytetarëve gjatë përballjes me krizën e migracionit.

"Jam i kënaqur që programet tona të trajnimit dhe pajisimit kanë arritur rezultate të shkëlqyera në përmirësimin e kapaciteteve të batalionit. Ne do të mbetemi të përkushtuar në mbështetjen dhe bashkëpunimin me ju edhe më tej", - tha Goodley. Për qëllimet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë nga viti 1996 deri më sot, nëpërmjet fondeve FMF (fond i SHBA-së për ndihmë ushtarake për jashtë) janë ndarë

115 milionë dollarë për pajisje dhe shërbime, si automjete të blinduara dhe pjesë këmbimi të tyre, mjete optike për vëzhgim në erësi, mjete moderne të komunikimit, armë, fluturake pa pilot dhe pajisje të tjera dhe më shumë. Në periudhën e ardhshme këto fonde do të vazhdojnë të përdoren në mbështetje të ARM-së dhe modernizimin e saj. Delegacioni nga Kongresi Amerikan nga 06-15 maj ndodhej për vizitë në Greqi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë dhe Itali.

Pjesëtarë të ARM në stërvitjen logjistike "LOGEX 17"

Anëtarët e Ushtrisë së Shtabit të Përgjithshëm të Maqedonisë: komandat vartëse dhe njësitë që kryejnë detyrat e logjistikës përfunduar pjesëmarrjen në stërvitjen logjistike "LOGEX 17", e cila u mbajt nga 8-19 maj në Tiranë. Stërvitja ishte me forca shumëkombëshe e angazhuar në misione jashtë territorit të saj. Ajo u ndoq nga nëntë vende, duke përfshirë dymbëdhjetë përfaqësues të Armatës së Maqedonisë.

Bazuar në skenar të krijuar më parë, pjesëmarrësit morën detyrat konkrete si njësi mbështetëse logjistike, në madhësinë e një brigade- Shumëkombëshe Task Forcave. Përfaqësuesit e ushtrisë maqedonase ishin anëtarë të qelizave të logjistikës operacioneve, planifikimit logjistikës, Elementit Mbështetës Kombëtar (NEP), të përbashkët në grup mbështetje logjistik, etj. Përveç përfaqësuesve të Ushtrisë maqedonase ishin edhe përfaqësues të armatave të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi, Republikës së Finlandës, Republikës së Moldavisë dhe Mbretërisë së Suedisë. Ushtrimi ishte sponsorizuar nga Shtetet e Bashkuara me qëllim të përmirësimit dhe forcimit të ndërveprimit midis pjesëmarrësve në planifikimin dhe ekzekutimin e logjistikës.



"Përdorimi i mjeteve shpërthyesë për qëllime ushtarake"

Batalioni i Operacioneve Speciale, pjesë e Regjimentit për Operacione Speciale dhe Batalioni i Xhenios nga Brigada e I-rë e mekanizuar e këmbësorisë "Krivollak" realizuan një stërvitje të përbashkët metodike eksperimentale "Përdorimi i mjeteve shpërthyesë për qëllime ushtarake".

Si pika e parë e ushtrimit ishte "Prishja e elementeve dhe materialeve", ku u demonstroi praktikisht thyerje në shpërthim si: hekurudhë, derë metalike, mur, urë prej druri dhe më shumë. Pika tjetër ishte realizimi i "Operacioneve ushtarake në një mjedis urban" ku duke u përdorur mjete shpërthyesë u bënë kalime nëpërmjet fushës së minuar, etj. Kurse pika e tretë dhe e fundit e operacionit ishte vendosja dhe ekzekutiminë priti duke përdorur mjete shpërthyesë të hedhura me helikopter.

Stërvitja u ndoq nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral lejtant Metodi Veliçkovski, drejtor i Shtabit Gjeneral Major Dimçe Petrovski, komandantët e Komandës së bashkuar operative, Regjimentit për operacione speciale, Brigadës së I-rë të mekanizuar të këmbësorisë dhe njësitë e tjera të ushtrisë. Pas përfundimit me sukses të stërvitjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm në fjalimin e tij tha se ky ushtrim është një shembull i madh se si këto dy njësi praktikisht bashkuan specialitetet e tyre profesionale për kryerjen me sukses të detyrave të ngarkuara.

Në shkollën “Skënderbej” ishim të gjithë si vëllezër

ALBERT Z. ZHOLI

Brezi i tij, i datëlindjes 1951–52 të shekullit të 20-të, ishte viti i fundit i shkollës së paorganizuar, pra shtatëvjeçare. Më pas, shkolla u bë me sistemin tetëvjeçar, që funksionoi gati për pesë dekada. Në shkollën e Dhok-satit të Lunxhërisë, Gjirokastër, ku ai bënte shkollën shtatëvjeçare, mbledheshin nxënës edhe nga Qestorati e Këllëzi, pas përfundimit të provimeve të lirim të vitin 1966, erdhën tre bursa për në shkollën ushtarake “Skënderbej” dhe një për në shkollën mekanike bujqësore në Durrës. Spirua ishte njëri nga ata të privilegjuarit, që përfituan bursën ushtarake, bursë që prindërit e tij e pritën me shumë entuziazëm, për vetë kushtet e vështira ekonomike që kishin, me shumë fëmijë dhe kur vetëm babai punonte, etj. Në këtë bisedë ai përcjell gjithë edukimin e tij ushtarak, në shkollat ku disiplina ishte përparësi dhe sakrifica gjë normale.

Ju keni thënë në bisedë se bashkë me ju në shkollën “Skënderbej” ishin dhe dy të tjerë. Kush ishin ata dhe si u nisët për në shkollë, çfarë emocione kishit?

Bashkë me mua, fatmirësisht, përfituan edhe dy nga shokët e mi më të mirë dhe që mbetëm të tillë edhe pas mbarimit të shkollës, madje gjer në fund, kushërimi im Mitro Çuçi dhe djali i mësuesit tonë të letërsisë, të respektuarit Fori Shabani, Lekua, një djalë i shkëlqyer. Me Mitron binim kushërinj nga prindërit tanë, babai i tij Koçua dhe mëma ime, Evua, ishin kushërinj të parë, të vetmit në Lunxhëri me mbiemrin Çuçi. Por kishim dhe një koicidencë shumë interesante me Mitron: mëmat tona na thoshin se na kishin lindur çuditërisht dhe mrekullisht në një ditë dhe në të njëjtën orë! Ne nuk e njihnim mistikën e shërbimit ushtarak dhe as e kishim idenë e një shkolle ushtarake, por gëzimi që se do të ishim përsëri bashkë, në të njëjtën shkollë, mbase dhe klasë, do të venim e vinim bashkë nga Tirana dhe, për çdogjië, do të ishim krah për njeri-tjetrin. Kishim dhe gëzime të tjera: unë kisha në Tiranë vëllanë tim të madh, Panajotin, të martuar e sistemuar me punë në Uzinën Partizani, i cili m'u bë vërtetë në vitet e shkollës jo vetëm si vëlla, por si një prind shembullor, me dashurinë dhe kujdesin e tij të pandarë. Kujtoj për këtë që çdo të diel, kur kishim liridallje, do veja patjetër në shtëpinë e tij, do haja një gjellë shtëpie, ëmbëlsira etj, do bisedonim gjatë dhe, duke ikur, do të merrja edhe ndonjë pesëdhjetëshe a qindëshe, që për ne atëhere ishte një gëzim i papërshkruar. Veç këtyre, vëllai im i dashur, kur kishte ndeshje futbolli ndërkombëtare, se nga gjente dhe më binte në postbllok një bilete, e cila ishte ëndërr për çdo begas. Këtë priste shoku ynë duarartë Aleks Haxhia, i cili ishte mjeshtër në pikturimin e 5 – 6 bileteve të tjera, të bëra aq bukur, si t'i kishte bërë fotokopje me ngjyra. Me këtë rast përfitonin edhe shokë të tjerë dhe futeshim si grup në stadium. Përveç Panajotit, kisha në Tiranë, gjithashtu edhe vëllanë tjetër më të madh nga unë, Ndrikon, që kryente shërbimin në Gardën e Republikës dhe në vëndrojen e tij Pallatin e Brigadave.

Në shkollën “Skënderbej” u njohëm me shumë shokë, ardhur nga gjithë Shqipëria, por unë do të përmend disa nga rrethi ynë, Gjirokastra, me të cilët venim e vinim bashkë në pushimet e simestrave. E thënë ndryshe, vuanim bashkë veshetërsitë e transportit me skoda të mbuluara, që na siguronte shkolla dhe që udhëtonim nga Tirana, Lushnjë, nëpër malësinë e Beratit, për të dalë në Këlcyrë, Ujë të Ftohtë e Gjirokastër. Ishim vetëm 14-18 vjeçarë, pra fëmijë. Në grupin tonë nga Gjirokastra ishin Sotir Mandili, Ylli Rrapi e Maksim Kilapi nga qyteti, Kostandin Thimjo nga Dropulli, Leonidha Bici, Dhimitër Joanidhi e Rako Focira nga Zagoria, Agim Golemi, Shaban Ligu e Muharrem Shkreli nga Labëria, Aleks Haxhia, Sadush Hysi e Selam Ymeri nga Asim Zeneli, etj. Por ky afrimiet, e thashë, që vetëm në fillim dhe vetëm kur udhëtonim si grup për në Gjirokastër, se pastaj, asnjë nga shokët nuk dallohej nga të tjerët për më shumë dashuri, apo më shumë besim.

Si ishte miqësia në shkollën “Skënderbej”?

Ne u bëmë shumë shokë edhe, fjala vjen, me Hamdi Eminin nga Kukësi, Bajram



Gosturanin nga Tropoja, që në pushimet e janarit vinte pas një muaji në shkollë, kur hapeshin udhët nga dëbora. U bëmë shokë me Dushan Shamentin e paharruar, që e rrëmbeu orteku në Feken me togën e tij. U njohëm me shokun tim të bankës, Kadri Mukën nga Berati bashkë me Pushkin Kapxhiun, Nasibi Nunajn, Avdyl Ahmetin, Sokrat Tumanin, Qani Kajën e Besim Qejvanin, Enver Kapxhiun nga Skrapari, me Zeno Jahaj, Pajtim Dervishi, Bardhosh Sevaj, etj nga Vlora, Shyqyri Topi, Flamur Malko, Petraq Groshi e Sabri Skraqi nga Lushnja, me grupin nga Korça Agim Matraku, Nexhdet Musallari, Gëzim Memelli, Taqo Trajçe, Përparim Meçollari, Ylber Çuçuli, Novruz Liço, Enver Merollari, Sokrat Shore, Tajar Koleci, Muhamet Potka, Nevzat Hysi, etj. Me Kristo Çuçin, Spiro Kokën, Petraq Papadhimën, etj nga Saranda, me Gjovalin Shytin, Dilaver Dika, Shefqet Lata nga Burreli, Bilal Kadëna e Luan Shehu nga Tepelena, Androkli Peçin, Maliq Vrekon, Luftar Pashollarin e Vangjel Papën nga Përmeti, Petrit Senja, Tahir Kurti e Tomorr Xhelo nga Gramshi, etj, etj.

Kë do të veçoje nga këto njohje?

Ne u njohëm me shumë shokë e bashkëpatriotë nga rrethi ynë edhe në klasat më të larta nga ne, ku do të përmendja veçanërisht “kujdestarin” dhe shokun tim, shkrimtarin, poetin dhe gazetarin e njohur nga Labova e Zhapës, Apostol Dukën. Ne u afruam me njeri tjetrin në fillim si shokë nga një krahinë, ku ai më thoshte “për çdo gjë, më ke mua këtu”. Unë nuk krijoja kurrë probleme në marrëdhënie me shokët, por Apostoli, i gjallë, i shkathët dhe shumë çapkën, më rrinte në krah gjithmonë si një vëlla më i madh. Më pas diskutonim krijimet tona të para, në fillim bashkë e pastaj me profesor Perikliun.

Kur filloi heqja e gradave ku ishit dhe si u përjetua në shkollë? Çfarë solli heqja e gradave?

Vetëm tre muaj më parë se të fillonim në shkollën “Skënderbej”, ishte marrë vendimi për heqjen e gradave në ushtri. Të them të drejtën, kur më thanë do vesh në shkollë ushtarake që të bëhesh oficer, më pëlqeu të imagjinoja se do vishesha ashtu bukur si Ilo Koti. Ilua, kur vinte në fshat i veshur ushtarak, fshati ndrinte dhe të gjithë dilnin ta shikonin tek sheshi i kishës, që ishte sheshi qëndror i fshatit tonë, Qestorati. Kur u hoqën gradat, u bënë të gjithë njësoj dhe s'mund të dalloje dot oficerin nga kapteri. Kur mora vesh se do bëhesha ushtarak, po pa grada, imazhi me uniformën e bukur të Ilo Kotit dhe me vetë bukurinë e tij, më mbeti vetëm si vegim, tej në kujtesë.

Në shkollën “Skënderbej” kishte degë, apo ishte gjimnaz?

Po, kishte! Pas përfundimit të karantinës së shtytave, ishim në pritje të ndarjes së klasave dhe degëve që do të ndiqnim. Atëhere ndiqeshin mësimet si skënderbegas edhe jashtë kësaj shkolle, në degën elektrike, mekanike, mjekësi, etj. Këto ishin degë shumë të preferuara (për ata që ua dinin vlerën), sepse pas përfundimit të tyre, vijeje studimet në universitet, në degët për inxhinieri elektrike,



mekanike, për mjekësi, etj, gjithnjë për të shërbyer në ushtri. Për ne të ardhurit nga fshati, që s'kishim idenë e këtyre degëve dhe luftës që bënin të tjerët për t'i përfituar ato, gjithë merakun e kishim të ishim bashkë me shokët në një klasë. Unë të isha bashkë me Mitro Çuçin e Leko Shabanin, kjo që e gjithë kënaqësia më e madhe. ... Erdhi dita e ndarjes së degëve. I dyti në listë nga gjithë begsat e atij viti, u lexua emri im. Këtu, më thanë, pas të parit që e kishte mesataren 10, unë fare pak më poshtë. Lexoheshin emrat me radhë, prit unë të vinte Lekua me Mitron, se dhe ata shumë mirë kishin qenë me mësimet, hiç. Ata u vendosën në klasën e gjashtë të kompanisë së dytë, dega e përgjithshme në shkollën “Skënderbej”. Ndërsa mua më kishin zgjedhur në degën elektrike, dmth po të vazhdoja, do isha bërë inxhinier elektrik ushtarak, si miku im Mihal Puleri, etj. Por, si mund të vazhdoja unë i vetëm studimet jashtë shkollës dhe dy shokët e mi brënda saj, veç nga unë? Ishte e pamundur! Si të bëja? Kë të pyesja? Mitrua e Lekua më shikonin si të isha bërë tjetër njeri,

jo shok i tyre. Pasdite vjen vëllai, Panajoti në postbllok, më kishte prurë ca thela byrek me lakra, që kishte bërë Ndina dhe që unë e haja shumë. Ke këtu dhe ndonjë thellë për Mitron e Lekon, më tha, por unë s'merrja dot, se s'na lejonin të merrnim gjëra ushqimore. E pyeta Panajotin si të bëja me degën elektrike, por ai nuk më dha përgjigje të prerë, pyet ata që vazhdojnë këtë degë, më tha dhe pastaj vendos vetë. Dhe unë e dini si vendosa? E lashë degën elektrike dhe u ktheva në shkollë me shokët e mi të fëmënisë. Kur vajta ju luta për këtë komisarit të shkollës, Agim Tepelena, një burrë i shtruar e i urtë, ai u çudit me kërkesën time. Ç'thua, more djalë, më tha?

Ne të zgjedhëm se ti ke qënë i shkëlqyer në mësimet, pa shiko mendohu dhe njëherë... Po, dëgjonte mendja ime prej fshatari të prapambetur se?! Sot mund të jem penduar për humbjen e këtij rasti, që mund të më kishte sjellë ndoshta një karrierë ndryshe. U ktheva në shkollë, por klasa ku qe Mitrua me Lekon ishte plotësuar dhe më vunë në klasën e tetë. Sidoqoftë ishim bashkë në gjithë orarin e veprimeve ditore, përveç orëve të mësimet dhe të studimit, ku secili i bënte në klasën e vet.

Si do ti cilësoje mësuesit dhe pedagogët në këtë shkollë?

Në shkollën “Skënderbej” 1966-1970 ishte një plejadë mësuesish dhe kuadrosh ushtarakë, që nuk do të fshihim kurrë nga kujtesa jonë. Aty vinin mësues të zgjedhur, nga më të përgatiturit dhe nga më të komunikueshit që mund të kishte në dispozicion ministria e arsimit. Mësuesja e anglishtes Shpresa Bejtja e më pas e mrekullueshmja Marie Nano, që na thoshte gjithmonë: “Mësoni djema anglisht, se do t'ju duhet!” Sikur ta parashikonte vërtetë këtë kohë, kur anglishtja është imediate, po ku dëgjonim ne atëhere? Të matematikës Pavli Bici e Shpëtim Bozo, të dy edhe albitra të basketbollit, me autoritetin e tyre të padiskutueshëm dhe të rëndë (thua e kishin marrë nga lënda që jepnin), megjithse ishin të dy të mirë dhe të bukur. I fizikës Bajram Shamku që më pas u bë dhe drejtor, në kohën tonë qe Fiqiri Shtëpani drejtor, i gjeografisë Petraq Ikononi (Peçi i thoshim ne, ishte shumë i lezetshëm në spjegim), i kimisë Bujar Llagami, etj, etj. Të letërsisë, pikës sime të dobët, i lashë për në fund, si ëmbëlsirën pas buke. Në klasën tonë ishte e famshnja Flutura Xoxe. E famshme, edhe për nga bukuria, edhe për nga pasioni i saj për letërsinë, por edhe sepse flitej që ishte personazhja e një romani, me shumë bujë në atë kohë. Flutura më donte shumë, ndoshta e pa prirjen time për letërsinë qysh atëhere dhe më inkurajonte. Arriti të më besonte aq shumë, derisa kur kishte ndonjë “punë të ngutshme”, më thoshte

mua të jepja mësimin e ri, sidomos kur qe koment i ndonjë vepre letrare. “Ja vazhdo ti Spiro, më thoshte, këtu e ke mësimin e ri” dhe ikte ato njëzetë minuta e vinte në fund të merrte regjistrin. Sa mall kam ta takoj prapë dhe t'i dhuroj librat e mi, që kam botuar ndër vite! Por mësues të letërsisë në atë kohë ishin edhe poeti Perikli Jorgoni si dhe mësuesja Gjylyzare Çiço, me të cilët kisha biseda të vazhdueshme, më shikonin krijimet e mia para se t'i nxirrja tek “Letrari i ri” i shkollës, më jepnin këshilla, më bënin redaktime, etj. Perikliu, qejfli edhe i futbollit, i famshëm me gjuajtjet e tij “braziliane”, më donte shumë. Jo pak herë në kohën e lirë, duke shëtitur, bisedonim për letërsinë. Atëkohë kishte nëpër duar një poemë, ku ndër të tjerët, kishte një varg ku thoshte se kanceri tallet me thikat e doktorëve.

Ju flisni me emocion për letërsinë, mbani mend kur ka qënë krijimi juaj i parë?

Ishte viti 1969. Kur ne ktheheshim nga pushimet e vitit të ri, unë u gdhiva tek kushërimi im në Gjirokastër Tase Floku, për të arritur në orën gjashtë të mëngjezit autobuzin dhe për t'u kthyer në shkollë. Në orën pesë Gjirokastra u zgjua nga sirenat, që bucinin nga çdo majë e anë e saj. Ishte ditë e “Aksionit me goditje të përqëndruar” për gjithë popullin e qytetit, i cili atë ditë do të hapte kanalin vaditës nga liqeni i Doftisë, përgjatë fushës së aviacionit e deri më tej Valaresë, disa km i gjatë. Sigurisht që mua kjo më bëri përshtypje të madhe dhe, sa u ktheva në shkollë, shkruajta poezinë, të cilën Perikliu e mori dhe e çoi vetë në redaksi. Gëzimi im, kur e pashë të botuar në faqet e 10 Korrikut, ishte i papërshkruar, po kështu edhe gëzimi i shokëve. Poezinë për liqenin e Doftisë, më pas e botova tek gazeta e Gjirokastër “Pararoja”. Kështu, pra, Perikli Jorgoni shënoi botimin tim të parë letrar, në vitin 1969, piketën e parë në atë rrugë që sot është “asfaltuar” goxha e gjatë, por akoma pa arritur deri në qendër të ish kryefshatit të Lunxhërisë, Qestoratit. Kur të “asfaltohet” gjer atje me librin “Mrekullia e jugut, Lunxhëria” që kam në proces përfundimtar, atëhere po, mund të them se çof bëra dhe një fushën e letrave shqiptare me kontributin tim modest.

Pas përfundimit të shkollës “Skënderbej” në cilën degë ju caktuan në “Shkolla e Bashkuar” dhe ku ju emëruan pas përfundimit?

Unë përfundova tankist. Një armë e bukur por që kishte vështirësitë e veta. Pas përfundimit të Shkollës së Bashkuar lumturisht mua më kishin caktuar në brigadën e tankeve të Elbasanit, bashkë me Çotin, (Sotir Mandilin). Gëzimi ynë që i jashtëzakonshëm, sidomos imi, sepse në Elbasan ishte vendosur me punë e banim vëllai im më i madh, Ndriku, ndërsa në Tiranë, kishim vëllanë e madh tonin, Panajotin. U përqafuam me Sotirin dhe thujse nuk e ndjemë aq thellë ndarjen me shokët e tjerë, të cilët nuk e fshehën gëzimin: “Lum si ju, përsëri bashkë!” Gëzim i madh ishte edhe për prindërit tanë në Qestorat e në Gjirokastër. Gjatë muajit të lejtës zbrita disa herë në Gjirokastër, takoheshim me Çotin, i gëzoheshim fatit të përbashkët dhe thurrim ëndrra për të ardhmen. Dita e parë dhe uniforma ime e parë e oficerit, ishte më 30 korrik 1972. Në këtë armë punova deri në vitin 1994 plot 22 vjet, sakrifica, stërvitje, gatishmëri, gëzime, hidhërimi, ndarje, bashkime, por me një betim në zemër: Ti shërbenim Atdheut në çdo çast!

Përfundon kursi i XI "Komando"

Përfundon Kursi i XI "Komando" të cilit iu nënshtruan këto trupa për rreth 3 muaj. Ky program përmbante tema nga më të larmishmet siç ishin: vrapimi 27 km me pajime, mbijetesë, alpinizëm në terrene tepër të thepisura shkëmbore, njohuri armatimi dhe qitje me ngarkesë. Të gjitha këto tema, ishin hartuar për të nxjerrë më të mirën nga secili kursant.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, drejtori i J-3/7 në Shtabin e Përgjithshëm

të Forcave të Armatosura kolonel Ilir Xhebexhia, komandati i Akademisë së Nënoficerëve kolonel Albert Muallaj, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Petrit Çuni si dhe komandantë të reparteve vartëse të Forcës Tokësore. Të ftuarit patën rastin të shikonin veprimet e trupave "komando" në disa stacione si: hedhje nga kulla e alpinizmit, reagimin e skuadrës "komando" në patrullim në kontakt me kundërshtarin, çlirim pengjesh, marrje objekti, qitje precizioni si dhe luftim trup me trup.

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, u shprehu kursantëve përgëzimet e tij më të mira për arritjen e përmbylljes me sukses të këtij kursi, kaq të rëndësishëm në jetën e tyre ushtarake. "Realizimi me sukses i këtij kursi nga ana juaj, demonstrimet që në patëm mundësi të shikojmë në të gjitha stacionet nga ana juaj, tregojnë më së miri nivelin e profesionalizmit që keni arritur në këto tre muaj, tregojnë shpirtin e çeliktë me të cilin jeni farkëtuar këto tre muaj, tregojnë që ju e meritoni ta mbani me nder dhe krenari beretën e kaltër"-tha ndër të tjera gjeneral Cahani.

